

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E AUDITIMIT BRENDSHËM

***PROJEKT – RAPORT***

***AUDITIMI***

***AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT***

***TIRANË***

***Lloji i auditimit: Përputhshmërie***  
***Periudha e audituar: 01.01.2021–31.12.2022***

***Tetor, 2023***

## PROJEKT RAPORT AUDITIMI

Mbi auditimin e kryer në Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT).

### **I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, (AKPT), është person juridik publik, buxhetor, me përgjegjësi planifikimi në varësi të MIE, që ushtron detyrat e përgjegjësitë e saj në bazë të ligjit nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar si dhe VKM nr.427, datë 8.6.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit”, me seli në Tiranë.

Përgjegjësitë dhe detyrat e AKPT-së janë përcaktuar në kreun III të VKM nr.427, datë 08.06.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit”; që janë:

1. Bashkërendon proceset e hartimit të dokumenteve të planifikimit e zhvillimit të territorit dhe mbështet bashkërendimin vertikal e horizontal ndërmjet autoriteteve të planifikimit të territorit.
2. AKPT-ja udhëheq, koordinon dhe ndërlihd veprimtaritë për modernizimin e modelit të planifikimit dhe promovimin e praktikave novatore në arkitekturë e planifikim.
3. AKPT-ja është përgjegjëse për informimin e proceseve të përmirësimit të legjislacionit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit.
4. AKPT-ja është përgjegjëse për administrimin dhe mirëmbajtjen e bazës së integruar të të dhënave të planifikimit dhe zhvillimit të territorit.
5. AKPT-ja është përgjegjëse për informimin e publikut për proceset e planifikimit të territorit, si dhe për nxitjen e pjesëmarrjes së tij gjatë proceseve të hartimit e zbatimit të dokumenteve të planifikimit.
6. AKPT-ja angazhon njësitë e saj përgjegjëse për të siguruar standardet ligjore, teknike dhe metodologjike të fushës së planifikimit e zhvillimit.
7. AKPT-ja është përgjegjëse për përgatitjen e studimeve për Sistemin e Integruar të Planifikimit në R. Shqipërisë dhe propozimet për ministrin përgjegjës për zhvillimin urban, Këshillin Kombëtar të Territorit dhe Këshillin e Ministrave për masat për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit dhe për procese e veprimtari në lidhje me planifikimin e zhvillimin e territorit.
8. AKPT-ja kujdeset që produktet e veprimtarisë kërkimore, analizuese e studimore, t’i vërë në dispozicion të zhvillimit të qëndrueshëm urban në Shqipëri.
9. AKPT-ja, çdo vit, harton Raportin Monitorues të Zbatimit të Qëllimeve dhe të Objektivave, të deklaruara në Planin e Përgjithshëm të Territorit dhe planet e detajuara për zona me rëndësi kombëtare.

AKPT-ja është institucion buxhetor, që financohet nga buxheti i shtetit, donacione të jashtme dhe burime të tjera të ligjshme. AKPT-ja siguron të ardhura edhe nga shërbimet e kryera prej saj ndaj palëve të tjera. AKPT-ja administron fonde buxhetore dhe ato të siguruar nga shërbimet ndaj palëve të tjera, sipas rregullave dhe parimeve të sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë.

Institucioni funksionon me strukturë dhe organikë të miratuar nga Kryeministri, e konkretisht sipas Urdhërit të Kryeministrit nr.42, datë 02.03.2020 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare e Planifikimit të Territorit”, sipas të cilit numri i përgjithshëm i punonjësve është 41 veta.

AKPT-ja funksionon bazuar në Rregulloren e Brendshme për organizimin dhe funksionimin e saj, miratuar me Urdhërin e Ministrit të MIE nr.310, datë 02.09.2021.  
Marrëdhëniet e punës të punonjësve të AKPT-së rregullohen sipas ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Për periudhën objekt auditimi, evidentohet se institucioni është organizuar konform dispozitës ligjore të krijimit, ka të përcaktuar fushën e veprimtarisë dhe është organizuar me struktura që mbulojnë veprimtaritë teknike sipas fushave të veprimtarisë dhe me strukturë mbështetëse për realizimin dhe funksionimin e aktiviteteve dhe raportimin ekonomik financiar.

*Objekti i auditimit:* Vlerësimi nëse veprimtaritë e institucionit janë në pajtim me ligjet, aktet nënligjore, aktet e brendshme dhe rregulloret. Objektivi i auditimit është të përcaktojë nivelin e përputhshmërisë të veprimeve të institucionit për realizimin e objektivave, zbatimin e akteve ligjore e nënligjore, rregullave të detyrueshme, standardeve, planeve, kontratave, politikave apo procedurave. Dhënia e rekomandimeve subjektit për përmirësimin e sistemeve.

*Procedurat e kryerjes së angazhimit:* Me shkresën nr.6754/1, datë 22.08.2023, të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm në MIE, është njoftuar AKPT, për fillimin e angazhimit të auditimit në këtë institucion. Më datë 07.09.2023, u zhvillua takim i fillestar me stafin, takim në të cilin ndër të tjera u identifikuan sistemet dhe u dha një panoramë e shkurtër e procedurave të punës që do të ndiqen nga grupi i auditimit.

Për identifikimin e sistemeve për auditim, grupi i auditimit u bazua në raportet e mëparshme të auditimit dhe dispozitat e organizimit dhe funksionimit, strukturën organizative dhe dokumentacionin e mbajtur.

Sistemet e identifikuar, për përmbushjen e objektivave të auditimit dhe të përcaktuara në programin e miratuar të auditimit janë: a. Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit; b. Sistemi i veprimeve dhe operacioneve me likuiditetet; c. Rregullshmëria e hartimit të Planeve të Detyruara Vendore për 9 bashki: Durrës, Kamëz: Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Shijak, Vorë; d. Sistemi i procedurave të prokurimit të fondeve publike; e. Sistemi i pagave të punonjësve; f. Sistemi i menaxhimit të aktiveve, kontabilizimi dhe raportimi financiar.

*Qëllimi i Auditimit:* Vlerësimi i veprimtarisë për realizimin e objektivave në Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Teritorit, rregullshmërinë dhe ligjshmërinë e funksionimit, vlerësimin e sistemeve në këtë institucion nëse është vepruar në përputhje me legjislacionin dhe rregullat përkatëse të fushës ku zhvillon aktivitetin, duke dhënë dhe rekomandimet përkatëse.

*Periudha objekt auditimi:* 01.01.2021 - 31.12.2022.

*Rezultatet e auditimit, përmbledhje e gjetjeve:*

Në përfundim të auditimit vlerësojmë se në fushat e përfshira në auditim; me gjithë punën e mirë të kryer nga stafi i AKPT-së, janë konstatuar të meta e parregullsi që çënojnë funksionimin e komponentëve të kontrollit të brendshëm. Komponentet e kontrollit të brendshëm nuk janë vlerësuar siç duhet nga niveli më i lartë i menaxhimit, pasi:

- Në sistemin e planifikimit dhe zbatimit të buxhetit, grupi i auditimit ka konstatuar se ka mangësi në fazën e Programimit të buxhetit lidhur me planifikimin e disa artikujve buxhetorë të shpenzimeve për të cilët programimi nuk është bërë i detajuar, nuk është argumentuar dhe nuk është mbështetur në dokumentacion të vlefshëm justifikues.

- Në sistemin e rregullshmërisë së hartimit të Planeve të Detyruara Vendore, gjatë procedurave të prokurimit, nuk janë ndjekur dhe zbatuar procedurat e parashikuara në VKM 354/2016, për përcaktimin e fondit limit, për prokurimet e kryera për Hartimin e Planeve të Detyruara Vendore për zonat e dëmtuara pikësore.
  - Në sistemin e procedurave të prokurimit të fondeve publike, grupi i auditimit ka konstatuar parregullsi në dokumentimin e lëvizjes së aktiveve, konkretisht në momentin e bërjes hyrje të blerjes së një automjeti, i cili është bërë hyrje, pa u bërë më parë marrja në dorëzim e tij, duke vepruar në kundërshtim me Udhëzimin e M. Financave nr.30 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 37.
- Për përmirësimin e parregullsive të sipërcituara, në këto sisteme, grupi i auditimit ka dhënë rekomandime, të cilat do të trajtohen nga subjekti i audituar.

Rekomandimet e lëna nga auditimet e mëparshme, janë audituar sipas programit të auditimit nr.2256 datë 08.03.2022.

**Vlerësimi i riskut:** Mbështetur në informacionin e disponuar në vlerësimin e funksionimit të sistemeve, realizimin e objektivave, mangësitë e konstatuar dhe të paraqitura në këtë material për periudhën e audituar, grupi i auditimit paraqet opinionin për vlerësimin e përgjithshëm të *riskut në nivel të mesëm*.

## II. HYRJE

Auditimi i përputhshmërisë përfshin vlerësimin nëse veprimtaritë e institucionit janë në pajtim me ligjet, aktet nënligjore, aktet e brendshme dhe rregulloret. Auditimet e përputhshmërisë kanë për qëllim të testojnë nëse institucioni vepron në përputhje me legjislacionin dhe rregullat përkatës të fushës ku zhvillon aktivitetin.

Objektivi i auditimit të përputhshmërisë, është të përcaktojë nivelin e përputhshmërisë të veprimeve të institucionit për realizimin e objektivave, zbatimin e akteve ligjore e nënligjore, rregullave të detyrueshme, standardeve, planeve, kontratave, politikave tregtare dhe procedurave që përcaktojnë drejtimit që do të auditohen.

*Auditimi u krye mbështetur në dispozitat ligjore:*

- Ligji nr.114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”;
- Manuali për Auditimin e Brendshëm, i miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar;
- Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Udhëzimi i MF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar;
- Ligji 25/2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”;
- VKM nr.783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe të rregullave kontabël”;
- Ligji nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;
- Ligji nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”;
- VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;
- VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- Ligji nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar;
- VKM nr.187, datë 08.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe niveleve të pagave...”, i ndryshuar;
- Ligji nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

- Ligji nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”. i ndryshuar;
  - VKM nr.427, datë 08.06.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit”;
  - Urdhër i Kryeministrit nr.42 datë 02.03.2020 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së AKPT;
  - Rregullore e brendshme e funksionimit të AKPT;
- Të ndryshme: akte të tjera ligjore e nënligjore, vendime, udhëzime e urdhëresa në fuqi.

Në zbatim të Planit Vjetor të auditimit për vitin 2023, të miratuar nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr.7088/3, datë 19.10.2022 dhe Programit të Angazhimit të Auditimit nr.7654/2, datë 15.09.2023, u krye ky angazhim auditimi në AKPT.

*Auditimi u krye nga grupi i punës i përbërë nga:*

1. Hikmet Kaso, përgjegjës grupi
2. Kristina Deliu, anëtare;

### **III. METODA E AUDITIMIT**

Metoda e përdorur në auditim është “testimi hap pas hapi” dhe e kombinuar me metodën e ekzaminimit, për të cilën u përzgjedhën transaksione specifike brenda çdo sistemi nga fillimi deri në fund, për të vlerësuar nëse institucioni është përmbajtur procedurave të caktuara si dhe për të dhënë një gjykim profesional në lidhje me përshtatshmërinë dhe efikasitetin e veprimeve të subjektit të audituar.

Teknika e përzgjedhjes në mënyrë rastësore u kombinua dhe me teknika të tjera si kontrolli aritmetik (listë pagesat, përlllogaritjen e pagave, faturat, ditarët analitik, etj), shqyrtimi i dokumentave justifikuese e krahasimi me dokumentin bazë dhe ekzaminimin analitik (në të gjithë sistemet e audituara sipas programit).

Për çdo sistem të mbuluar me auditim u përzgjedhën mbi 25% të transaksioneve, procedurave të zhvilluara ose të veprimeve të kryera.

Në përfundim të misionit të auditimit, mbështetur në konkluzionet e nxjerra nga vlerësimi i të gjithë dokumentacionit të veprimtarisë audituese, u hartua ky Projekt Raport, i cili i vihet në dispozicion institucionit të audituar.

### **IV. GJETJET KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET PËR CDO SISTEM**

Në përfundim, grupi i auditimit pasqyron vlerësimin e sistemeve, respektivisht sipas programit të auditimit, si më poshtë vijon:

#### **1. Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit.**

*Objektivi i auditimit.*

Vlerësimi nëse hartimi, miratimi dhe zbatimi i programit të zhvillimit ekonomik është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe objektivat e shoqërisë.

*Fushat të cilat do të merren në konsideratë gjatë auditimit:*

- Rregullshmëria e hartimit të programit të zhvillimit ekonomik dhe dokumentimi i këtij procesi, për periudhën objekt auditimi.
- Realizimi i treguesve ekonomiko-financiare të miratuar për vitet 2021 dhe 2022. Analizë e shkurtër e shpenzimeve të aktivitetit sipas zërave, krahasimi i tyre me ato të programuara.
- Raportimi periodik i monitorimit të performancës së institucionit në organet drejtuese.

Grupi i auditimit për auditimin e sistemit të programimit dhe zbatimit të buxhetit pati në konsideratë 3 fazat kryesore të këtij sistemi. Pas dokumentimit të sistemit dhe vlerësimit të funksionimit të kontrolleve të vendosura për sistemin nëpërmjet testimeve të kryera rezultoi si më poshtë:

### **Hartimi i Programit Buxhetor Afatmesëm**

**Për vitin 2021**, përgatitja e Programit Buxhetor Afatmesëm është mbështetur në Ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; Ligjin nr.137/2020 “Për Buxhetin e Vitit 2021”, Udhëzimin të Ministrit të Financave nr.7 datë 28.02.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, dhe Udhëzimin Plotësues të Ministrit të Financave nr.28, datë 10.07.2020 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023”.

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit me shkresën nr.825/01 datë 28.08.2020 drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë ka paraqitur Programin Buxhetor Afatmesëm 2021-2023 i cili është plotësuar sipas formateve të përcaktuara në Udhëzimin Plotësues të Ministrit të Financave nr.28, datë 10.07.2020 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021 – 2023”.

### ***Parashikimi i shpenzimeve:***

Në Programin Buxhetor Afatmesëm për vitin 2021 – 2023 AKPT ka paraqitur në mënyrë të detajuar në kapituj e artikuj për të gjithë shpenzimet e aktivitetit.

Kërkesa buxhetore për paga dhe sigurime është bërë e detajuar dhe e mbështetur në strukturën e institucionit dhe bazën ligjore në fuqi për pagat dhe sigurimet. E vërtetohet së në kërkesën Buxhetore nuk është përfshirë kërkesa për paga dhe sigurime për punonjësit e rekrutuar me kontrata të përkohshme në kuadër të rindërtimit referuar shkresës së Ministrisë së Rindërtimit nr. 3414/1 datë 02.03.2021.

Grupi i auditimit ka konstatuar se parashikimi i bërë në kërkesat buxhetore për shpenzime operative nuk është detajuar në nënartikuj në këtë fazë, nuk është argumentuar dhe nuk është mbështetur në dokumentacion justifikues. Kjo çështje trajtohet më hollësisht në gjetjen në vijim të materialit.

Kërkesa buxhetore për investime është bërë e argumentuar dhe e detajuar sipas zërave që kërkohen. Nga ana e Drejtorisë së Menaxhimit të Buxhetit në MFE është dërguar miratimi i buxhetit të shpenzimeve korente për vitet 2021 – 2023 me shkresën nr.23724/97 prot. datë 18.01.2021 protokolluar nga AKPT me nr.121, datë 22.01.2021. Buxheti fillestar i akorduar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për shpenzime korente në zbatim të ligjit nr.137/2020 “Për Buxhetin e Vitit 2021”, për programin e vetëm buxhetor 01150 “Shërbime të tjera” produkti “Hartimi i Planeve të Përgjithshme kombëtare dhe vendore” është në vlerën 70,020,000 lekë.

Po ashtu nga kjo drejtori është dërguar edhe detajami i buxhetit të vitit 2021 – 2023 për shpenzimet kapitale në programin buxhetor 01150 “Shërbime të tjera” me shkresën nr.23724/227 prot., datë 08.03.2021 protokolluar nga AKPT me nr.358, datë 10.03.2021. Buxheti fillestar i akorduar për shpenzime kapitale nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në zbatim të Ligjit nr.137/2020 “Për

Buxhetin e Vitit 2021”, për programin e vetëm buxhetor 01150 “Mbështetje për Industrinë” është në vlerën 18,756,000 lekë.

Programi Buxhetor i miratuar për vitin 2021 ka pësuar ndryshime gjatë vitit. Pasqyra e planifikimit të buxhetit për vitin 2021 dhe ndryshimet që ka pësuar gjatë vitit paraqiten në mënyrë të detajuar si më poshtë:

Nr.	Nr. Llogarie	Përshkrimi	Kërkesa Buxhetore	Buxheti Fillestar i Miratuar	Buxheti i ndryshuar	Diferenca
1	600	Pagat	37,000,000	37,000,000	43,000,000	6,000,000
2	601	Sigurimet	6,797,000	5,297,000	7,097,000	1,800,000
3	602	Mallra dhe Shërbime	24,823,000	27,723,000	19,875,000	(7,848,000)
4	606	Fondi i vecante			238,000	238,000
5	230	Shpenzime Kapitale të Patrupëzuara	10,040,000	12,796,000	60,748,410	47,952,410
5.1.	230	Planifikimi i Modeleve të Zhvillimit për 100 Fshatrat (M064246)	10,040,000	10,040,000	12,796,000	2,756,000
5.2.	230	Hartimi i Planeve të Detyruara Vendore për 9 Bashki 19AA001			47,952,410	47,952,410
5.3.	230	Fondi i Ngrirë (M870013)		2,756,000		(2,756,000)
6	231	Shpenzime Kapitale të Trupëzuara	960,000	5,960,000	5,960,000	-
6.1.	231	Planifikimi në Nivel Qëndror dhe Monitorimi i Territorit (18AN901)		5,000,000	5,000,000	-
6.2.	231	Pajisje Informatike (18AO601)	960,000	960,000	960,000	-
7		Grant - Projekti Brigaid "Kapërcimi i barrierave në fushën e inovacionit me qëllim ripërtëritjen ndaj katastrofave"			5,447,258	5,447,258
7.1.	602	Projekti Brigaid - Shpenzime Korente			1,647,258	1,647,258
7.2.	231	Projekti Brigaid - Investime			3,800,000	3,800,000
<b>Totali</b>			<b>79,620,000</b>	<b>88,776,000</b>	<b>142,365,668</b>	<b>53,589,668</b>

Nga të dhënat e mësipërme, rezulton se gjatë vitit 2021, buxheti fillestar ka pësuar ndryshime duke u rritur në vlerë totale 53,589,668 lekë. Kanë ndryshuar disa zëra buxhetorë nga miratimi fillestar: -Artikulli Buxhetor 600 “Paga” është miratuar fillimisht nga MIE në vlerën 37,000,000 lekë dhe më pas është ndryshuar duke u shuar në vlerë totale prej 6,000,000 lekë mbështetur në kërkesën e AKPT drejtuar MFE me nr.195/01 prot., datë 19.02.2021 “Rialokim fondi”. Kjo kërkesë është miratuar nga MFE me shkresën nr.3607/1 prot., datë 01.03.2021 “Transferim fondi për vitin 2021”. Kërkesa e AKPT është argumentuar me faktin që gjatë vitit 2021 AKPT ka punësuar specialistë me kontrata të përkohshme referuar shkresës nr.3414/1 prot. datë 02.03.2021 me lëndë “Transferim fondi për vitin 2021”.

-Artikulli Buxhetor 601 “Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore” është miratuar fillimisht nga MIE në vlerën 5,297,000 lekë dhe më pas është ndryshuar duke u shtuar në vlerë totale prej 1,800,000 lekë mbështetur mbështetur në kërkesën e AKPT drejtuar MFE me nr.195/01 prot., datë 19.02.2021 “Rialokim fondi”. Kjo kërkesë është miratuar nga MFE me shkresën nr.3607/1 prot., datë 01.03.2021 “Transferim fondi për vitin 2021”.

-Artikulli Buxhetor 602 “Mallra dhe shërbime” është miratuar fillimisht nga MFE në vlerën 27,723,000 lekë dhe më pas është ndryshuar duke u pakësuar në vlerë totale prej 7,848,000 lekë mbështetur mbështetur në:

a) Kërkesën e AKPT drejtuar MFE me nr.195/01 prot., datë 19.02.2021 “Kërkesë për Rialokim fondi” për të rishpërndarë vlerën prej 7,800,000 lekë nga artikulli buxhetor 602 “Mallra dhe shërbime” në artikullin buxhetor 600 “Paga” dhe 601 “Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore”.

Kjo kërkesë është miratuar nga MFE me shkresën nr.3607/1 prot., datë 01.03.2021 “Transferim fondi për vitin 2021.

b) Kërkesën e AKPT drejtuar MFE me nr.407 prot., datë 19.03.2021 “Kërkesë për Rialokim fondi” për të rialokuar vlerën prej 48,000 lekë nga buxhetor 602 “Mallra dhe shërbime” në artikullin buxhetor 606 “Fondi i vecantë”. Kjo kërkesë është miratuar nga MFE me shkresën nr.5319/1 prot., datë 01.04.2021 “Transferim fondi për vitin 2021”.

-Artikulli Buxhetor 606 “Fondi i Vecantë” për vitin 2021 është shtuar në vlerë totale prej 238,000 lekë e detajuar si vijon:

a) Është miratuar nga MFE me shkresën nr.1381/13, datë 11.02.2021 në vlerën 100,000 lekë.

b) Kërkesën e AKPT drejtuar MFE me nr.407 prot., datë 19.03.2021 “Kërkesë për Rialokim fondi”. Kjo kërkesë është miratuar nga MFE me shkresën nr.5319/1, datë 01.04.2021 “Transferim fondi për vitin 2021 në vlerën 48,000 lekë.

c) Kërkesën e AKPT drejtuar MFE me nr.931, datë 05.08.2021 “Kërkesë për Rialokim fondi”. Kjo kërkesë është miratuar nga MFE me shkresën nr.13973/1, datë 09.08.2021 “Për një shtesë të fondit të vecantë” në vlerën 90,000 lekë.

- Artikulli Buxhetor 230 “Investime në proces – Aktive të trupëzuara” për vitin 2021 është shtuar në vlerë totale prej 47,952,410 lekë mbështetur në shkresën e MFE nr.3520/1, datë 11.03.2021 “Mbi trashëgimin e fondeve të rindërtimit për vitin 2021”.

-Artikulli Buxhetor 230 “Investime në proces – Aktive të trupëzuara” është miratuar fillimisht nga MFE në vlerën 5,960,000 lekë dhe nuk ka pasur ndryshime gjatë vitit 2021.

- Artikulli Buxhetor 602 dhe 231 për grupin 6 të shpenzimeve ka pësuar shtesë gjatë vitit 2021 nga alokimi i grantit për projektin “Brigaid-Kapërcimi i barrierave në fushën e inovacionit me qëllim ripërtëritjen ndaj katastrofave” në zbatim të akt marrëveshjes së datës 09.11.2021. Fondet e këtij projekti janë trashëguar në vitin 2022.

**Për vitin 2022**, përgatitja e Programit Buxhetor Afatmesëm është mbështetur në Ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, Ligjin nr. 115/2021 “Për Buxhetin e Vitit 2022”; Udhëzimin të Ministrit të Financave nr.7 datë 28.02.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm, Udhëzimin Plotësues të Ministrit të Financave nr.19, datë 09.07.2021 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”.

Agjensia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për të dyja fazat e planifikimit ka paraqitur Programin Buxhetor Afatmesëm i cili është plotësuar në sipas formateve të përcaktuara në Udhëzimin Plotësues të Ministrit të Financave nr.8, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022 – 2024”, konkretisht:

-Me shkresën nr.565 prot. datë 28.04.2021 drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë ka paraqitur Programin Buxhetor Afatmesëm 2022 – 2024 (Faza I - Strategjike);

-Me shkresën nr.923/01 prot. datë 27.08.2021 drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë ka paraqitur Programin Buxhetor Afatmesëm 2022 – 2024 (Faza II - Teknike);

-Me shkresën nr.1376/01 prot. datë 20.12.2021 drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë ka paraqitur Programin Buxhetor Afatmesëm 2022 – 2024 (Faza III).

### ***Parashikimi i shpenzimeve:***

Në Programin Buxhetor Afatmesëm për vitin 2022 – 2024 AKPT ka paraqitur në mënyrë të detajuar në kapituj e artikuj për të gjithë shpenzimet e aktivitetit.

Kërkesa buxhetore për paga dhe sigurime të stafit të AKPT është bërë e detajuar dhe e mbështetur në strukturën e institucionit dhe bazën ligjore në fuqi për pagat dhe sigurimet. Evidentohet së në



kërkesën Buxhetore nuk është përfshirë kërkesa për paga dhe sigurime për punonjësit e rekrutuar në kuadër të rindërtimit sipas shkresës së Ministrisë së Rindërtimit nr.3-14/1 prot. datë 02.03.2021.

Grupi i Auditimit ka konstatuar se parashikimi i bërë në kërkesat buxhetore për shpenzime operative nuk është detajuar në nënartikuj, nuk është argumentuar dhe nuk është mbështetur në dokumentacion justifikues. Kjo çështje trajtohet më hollësisht në gjetjen në vijim të materialit. Kërkesa buxhetore për investime është bërë e detajuar sipas zërave që kërkohen.

Nga konstatimet sa sipër për funksionimin e fazës së hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm Grupi i Auditimit ka këtë gjetje:

**Titulli gjetjes:** Parregullsi dhe mosdokumentim i procesit të programimit të buxhetit.

<b>Nr.i gjetjes: 1</b>	
Subjekti i audituar	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit; Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Përmbledhja e bazës ligjore	Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në R.Shqipërisë”, Udhëzimi standart nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së PBA dhe udhëzimet vjetore të përgatitjes së buxhetit”
Përshkrimi i gjetjes	<p><b>Situata:</b> Gjatë fazës së përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm nuk janë plotësuar të gjitha kërkesat ligjore për hartimin e kërkesave buxhetore. Kështu:</p> <p>1. Në Kërkesat Buxhetore nuk është përfshirë kërkesa për paga dhe sigurime për punonjësit e rekrutuar në kuadër të rindërtimit referuar shkresës së Ministrisë së Rindërtimit nr. 3-14/1 prot. datë 02.03.2021.</p> <p>2. Në planifikimin e shpenzimeve operative, artikulli 602 “Mallra dhe shërbime të tjera”, për secilin vit të audituar, është vënë vetëm shuma e kërkuar për artikullin por nuk është detajuar në nënzëra duke bërë kështu të vështirë vlerësimin e saktësisë së këtyre kërkesave nga palët e treta (organet e prore, grupi i auditimit etj.)</p> <p>Për vitin 2021, sipas formularit të dërguar në MFE, AKPT kërkon fonde buxhetore për mallra e shërbime shumë 24,823,000 lekë. Kjo shumë nuk është e argumentuar me asnjë evidencë apo raport se cilat janë mallrat apo shërbimet dhe si janë llogaritur kostot përkatëse për këto mallra apo shërbime.</p> <p>Për vitin 2022, sipas formularit të dërguar në MFE, akptkërkon fonde buxhetore për mallra e shërbime shumë 26,946,000 lekë. Kjo shumë nuk është e argumentuar me asnjë evidencë apo raport se cilat janë mallrat apo shërbimet dhe si janë llogaritur kostot përkatëse për këto mallra apo shërbime.</p> <p><b>Kriteri:</b> Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor” i ndryshuar; pika 8 e Udhëzimit standart nr.7, datë</p>

	<p>28.02.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së PBA dhe udhëzimet vjetore të përgatitjes së buxhetit";</p> <p><b>Ndikimi/Efekti:</b> Pasiguri lidhur me parashikimin e nevojave për shërbime, llogaritjes së tyre sipas zërave të planifikuar dhe krijimi i pamundësisë për vlerësimin e saktësisë së këtyre kërkesave nga palët e treta (organet e prore, grupi i auditimit etj.)</p> <p><b>Shkaku:</b> Moszbatim i disa kërkesave ligjore për hartimin e kërkesave buxhetore.</p>
Vlerësimi i nivelit të riskut	I Mesëm
Konkluzioni	Procesi i planifikimit në fazën e Programimit të buxhetit për paga dhe shpenzime operative nuk është bërë i detajuar, nuk është argumentuar dhe nuk është mbështetur në dokumentacion të vlefshëm justifikues duke krijuar kështu pasiguri në saktësinë e nevojave për shërbime dhe llogaritjes së kostove të tyre sipas zërave të planifikuar si dhe krijimin e pamundësisë për analizën e realizimit të detajuar të buxhetit.
Rekomandime	Nga AKPT të merren masa për përmirësimin e punës në drejtim të argumentimit të kërkesave buxhetore dhe mbështetjes së tyre në dokumentacion justifikues.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Për tu kompletuar në kohën e hartimit të Raportit Përfundimtar.
Statusi i rekomandimit	Për tu përcaktuar mbas fazës së observacioneve.

Nga ana e Drejtorisë së Menaxhimit të Buxhetit në MFE është dërguar miratimi i buxhetit të shpenzimeve korente për vitet 2022 – 2024 me shkresën nr.22922/92 prot. datë 18.01.2022. Buxheti fillestar i akorduar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për shpenzime korente në zbatim të ligjit nr.115/2021 "Për Buxhetin e Vitit 2022" për programin e vetëm buxhetor 01150 "Shërbime të tjera" produkti "Hartimi i planeve të përgjithshme kombëtare dhe vendore" është në vlerën 69,744,000 lekë.

Gjithashtu nga kjo drejtori është dërguar edhe detajimi i buxhetit të vitit 2022 – 2024 për shpenzimet kapitale në programin buxhetor 01150 "Shërbime të tjera" me shkresën nr.5739 prot., datë 29.03.2022. Buxheti fillestar i akorduar për shpenzime kapitale nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në zbatim të Ligjit nr. 115/2021 "Për Buxhetin e Vitit 2022" për programin e vetëm buxhetor 01150 "Shërbime të Tjera" është në vlerën 15.253,000 lekë.

Programi Buxhetor i miratuar për vitin 2022 ka pësuar ndryshime gjatë vitit. Pasqyra e planifikimit të buxhetit për vitin 2022 dhe ndryshimet që ka pësuar gjatë vitit paraqiten në mënyrë të detajuar si më poshtë:

Nr.	Nr. Llogarie	Përshkrimi	Kërkesa Buxhetore	Buxheti Fillestar i Miratuar	Buxheti i ndryshuar	Diferenca
1	600	Pagat	37,000,000	36,000,000	37,900,000	1,900,000
2	601	Sigurimet	6,797,000	6,798,000	6,628,050	(169,950)
3	602	Mallra dhe Shërbime	26,946,000	26,946,000	21,041,400	(5,904,600)

4	606	Fondi i vecante			600,000	600,000
5	230	Shpenzime Kapitale të Patrëpëzuara	10,040,000	-	28,844,132	28,844,132
5.1.	230	Hartimi i Planeve të Detyruara Vendore për 9 Bashki 19AA001			26,218,856	26,218,856
5.2.	230	Planifikimi i Modeleve të Zhvillimit për 100 Fshatrat (M064246)	10,040,000		2,625,276	2,625,276
6	231	Shpenzime Kapitale të Trupëzuara	4,213,000	15,253,000	2,000,000	(14,453,000)
6.1.	231	Planifikimi në Nivel Qëndror dhe Monitorimi i Territorit (18AN901)	3,253,000	14,253,000		(14,253,000)
6.2.	231	Pajisje Informatike (18AO601)	960,000	1,000,000	1,200,000	(200,000)
6.3.	231	Pajisje M0870019			800,000	
7		Grant		5,447,258	5,447,258	-
7.1.	602	Projekti Brigaid - Shpenzime Korente		1,647,258	1,647,258	-
7.2.	231	Projekti Brigaid - Investime		3,800,000	3,800,000	-
<b>Totali</b>			<b>84,996,000</b>	<b>90,444,258</b>	<b>102,460,840</b>	<b>10,816,582</b>

Siç shihet nga të dhënat në tabelë gjatë vitit 2022 buxheti fillestar i MIE ka pësuar ndryshime duke u rritur në vlerë totale prej 10,816,582 lekë. Kanë ndryshuar disa zëra buxhetorë nga miratimi fillestar:

- Artikulli Buxhetor 600 "Paga" është miratuar fillimisht nga MIE në vlerën 36,000,000 lekë dhe më pas është ndryshuar duke u rritur në vlerë totale prej 1,900,000 lekë mbështetur në:

a) Aktin normativ nr.3, datë 12.03.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022" sipas të cilit ky artikull buxhetor ka pësuar pakësim në vlerën 900,000 lekë; b) Kërkesën e AKPT drejtuar MFE me nr.1330 prot., datë 16.09.2022 "Rialokim fondi" për të rishpërndarë vlerën prej 2,800,000 lekë nga artikulli buxhetor 602 "Mallra dhe shërbime" në artikullin buxhetor 600 "Paga". Kjo kërkesë është argumentuar nga ana e AKPT me faktin që fondi i alokuar nga MFE nuk mbulon shpenzimet financiare të pagave të punonjësve. Kjo kërkesë është miratuar nga MFE me shkresën nr.17126/1 prot., datë 23/09.2022 "Transferim fondi për vitin 2022".

-Artikulli Buxhetor 601 "Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore" është miratuar fillimisht nga MIE në vlerën 6,798,000 lekë dhe më pas është ndryshuar duke u pakësuar në vlerë totale prej 169,950 lekë mbështetur në Aktin Normativ nr.3, datë 12.03.2022 "Për disa ndryshime në ligjin nr.115/2021 "Për buxhetin e vitin 2022".

- Artikulli Buxhetor 602 "Mallra dhe shërbime" është miratuar fillimisht nga MFE në vlerën 26,946,000 lekë dhe më pas është ndryshuar duke u pakësuar në vlerë totale prej 5,904,000 lekë mbështetur në:

a) Aktin Normativ 3, datë 12.03.2022 "Për disa ndryshime në ligjin nr.115/2021 "Për buxhetin e vitin 2022";

b) Kërkesën e AKPT drejtuar MFE me nr.1330 prot., datë 16.09.2022 "Rialokim fondi" për të rishpërndarë vlerën prej 2,800,000 lekë nga artikulli buxhetor 602 "Mallra dhe shërbime" në artikullin buxhetor 600 "Paga". Kjo kërkesë është argumentuar nga ana e AKPT me faktin që fondi i alokuar nga MFE nuk mbulon shpenzimet financiare të pagave të punonjësve. Kjo kërkesë është miratuar nga MFE me shkresën nr.17126/1 prot., datë 23/09.2022 "Transferim fondi për vitin 2022".

- Artikulli Buxhetor 606 "Fondi i Vecantë" është shtuar me 190,000 lekë mbështetur në ligjin 115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022" dhe në vlerën 410,000 mbështetur në VKM nr.898, datë 29.12.2022.

- Artikulli Buxhetor 230 "Investime në proces – Aktive Afatgjata të trupëzuara" është miratuar fillimisht nga MFE në vlerën 0 lekë dhe më pas është ndryshuar duke u shtuar në vlerë totale prej 28,844,132 lekë mbështetur në:

a) Shkresën nr. 7000 prot., datë 14.04.2022 "Mbi trashëgimin e fondeve të rindërtimit për vitin 2022";

b) Kërkesën e AKPT drejtuar MFE me nr.591/01 prot., datë 05.04.2022 "Rialokim fondi". Kjo kërkesë është argumentuar nga ana e AKPT me faktin që fondi i alokuar nga MFE nuk ka përfshirë projektin "Planifikimi i Modeleve të Zhvillimit për 100 Fshatrat – Itinerari Kulturor Gjurmët Fishtane", projekt ky në vazhdim i cili ka nisur në vitin 2021 dhe ka përfunduar në muajin Shkurt të vitit 2022. Kjo kërkesë është miratuar nga MFE me shkresën nr.17126/1 prot., datë 23/09.2022 "Transferim fondi për vitin 2022".

- Artikulli Buxhetor 231 "Investime në proces – Aktive Afatgjata të trupëzuara" është miratuar fillimisht nga MIE në vlerën 17,000,000 lekë dhe më pas është ndryshuar duke u pakësuar në vlerë totale prej 16,200,000 mbështetur në:

a) Aktin Normativ 17, datë 03.12.2021 "Për disa ndryshime në ligjin nr.115/2021 "Për buxhetin e vitin 2022";

b) Kërkesën e AKPT drejtuar MFE me nr.591/01 prot., datë 05.04.2022 "Rialokim fondi". Kjo kërkesë është argumentuar nga ana e AKPT me faktin që fondi i alokuar nga MFE nuk ka përfshirë projektin "Planifikimi i Modeleve të Zhvillimit për 100 Fshatrat – Itinerari Kulturor Gjurmët Fishtane", projekt ky në vazhdim i cili ka nisur në vitin 2021 dhe ka përfunduar në muajin Shkurt të vitit 2022. Kjo kërkesë është miratuar nga MFE me shkresën nr.17126/1 prot., datë 23.09.2022 "Transferim fondi për vitin 2022".

**Realizimi i treguesve ekonomik-financiare të miratuar për vitet 2021 dhe 2022. Analizë e shkurtër e shpenzimeve të aktivitetit sipas zërave, krahasimi i tyre me ato të programuara.**

#### **Realizimi i shpenzimeve 2021**

Për vitin 2021, Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit i janë akorduar fonde buxhetore në total për të gjithë artikujt buxhetorë me gjithë ndryshimet gjatë vitit buxhetor në shumën 142,365,668 lekë nga të cilat janë realizuar 79,853,426 lekë, ose 56% e artikujve buxhetorë të planifikuar.

Realizimi i buxhetit i detajuar sipas artikujve dhe i krahasuar me planin paraqitet si më poshtë:

Nr.	Nr. Llogarie	Përshkrimi	Plani Vjetor i Ndryshuar	Realizimi në vlerë	Ndryshimi Plan - Fakt	Realizimi në %
1	600	Pagat	43,000,000	39,409,634	3,590,366	92%
2	601	Sigurimet	7,097,000	6,540,833	556,167	92%
3	602	Mallra dhe Shërbime	19,875,000	9,213,738	10,661,262	46%
4	606	Fondi i vecante	238,000	208,530	29,470	88%
	230	Shpenzime Kapitale të Trupëzuara	60,748,410	23,906,211	36,842,199	39%
5	231	Shpenzime Kapitale të Trupëzuara	5,960,000	574,480	5,385,520	10%
7	602+231	Grant - Projekti Brigaid	5,447,258	-	5,447,258	0%
<b>Totali</b>			<b>142,365,668</b>	<b>79,853,426</b>	<b>62,512,242</b>	<b>56%</b>

Shpenzimet për Paga/kap. 1 për vitin 2021 janë realizuar në masën 92%; Shpenzimet për Sigurime/kap. 1 për vitin 2021 janë realizuar në masën 92%.

Shpenzimet Operative 602/ kap.01 për vitin 2021 janë realizuar në masen 46%. Analiza e këtij zëri buxhetor në mënyrë të detajuar është e pamundur duke qënë se ky zë nuk është argumetuar dhe detajuar në fazën e planifikimit (gjetja më sipër)

Shpenzimet Operative 606/ kap.01 për vitin 2021 janë realizuar në masen 88%.

Investimet në proces (230), për vitin 2021 janë realizuar në masen 39%. Fondi per projektin "Hartimi i PDYV-ve" që zë pjesën kryesore të kësaj llogarie ka kaluar nga Ministria e Rindertimit (Fondi i Rindertimit) dhe realizimi i tyre (PDYV-ve) është bërë referuar vendimeve te Komisionit Shtetëror te Rindertimit. Fondi i mbetur trashëgohet në vitin pasardhës.

Investimet në proces (231), për vitin 2021 janë realizuar në masen 10%.

Fondet e projektit Brigaid për vitin 2021 nuk janë përdorur. Fondet e këtij projekti janë trashëguar në vitin 2022.

### **Realizimi i shpenzimeve 2022**

Për vitin 2022, Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit i janë akorduar fonde buxhetore në total për të gjithë artikujt buxhetorë me gjithë ndryshimet gjatë vitit buxhetor në shumën 102,460,540 lekë. Nga fondet e planifikuara dhe të akorduara janë realizuar 66,300,1256 lekë, ose 65% e artikujve buxhetorë të planifikuar.

Realizimi i buxhetit i detajuar sipas artikujve dhe i krahasuar me planin paraqitet si më poshtë:

Nr.	Nr. Llogarie	Përshkrimi	Buxheti i ndryshuar	Realizimi në vlerë	Ndryshimi Plan - Fakt	Realizimi në %
1	600	Pagat	37.900.000	37.047.743	852.257	98%
2	601	Sigurimet	6.628.050	6.174.772	453.278	93%
3	602	Mallra dhe Shërbime	21.041.400	11.559.718	9.481.682	55%
4	606	Fondi i vecante	600.000	531.178	68.822	89%
5	230	Shpenzime Kapitale të Patrupëzuara	28.844.132	6.063.276	22.780.856	21%
6	231	Shpenzime Kapitale të Trupëzuara	2.000.000	1.455.439	544.561	73%
7	602+231	Grant - Projekti Brigaid	5.447.258	3.468.000	1.979.258	64%
<b>Totali</b>			<b>102,460,840</b>	<b>66,300,126</b>	<b>36,160,714</b>	<b>65%</b>

Shpenzimet për Paga/kap. 1 për vitin 2022 janë realizuar në masën 98%; Shpenzimet për Sigurime/kap. 1 për vitin 2022 janë realizuar në masën 93%.

Shpenzimet Operative 602/ kap.01 për vitin 2022 janë realizuar në masen 55%.

Shpenzimet Operative 606/ kap.01 për vitin 2022 janë realizuar në masen 89%.

Investimet në proces (230), për vitin 2022 janë realizuar në masen 21%. Fondi per projektin "Hartimi i PDYV-ve" që zë pjesën kryesore të kësaj llogarie ka kaluar nga Ministria e Rindertimit (Fondi i Rindertimit) dhe realizimi i tyre (PDYV-ve) është bërë referuar vendimeve te Komisionit Shtetëror te Rindertimit. Fondi i mbetur trashëgohet në vitin pasardhës.

Investimet në proces (231), për vitin 2021 janë realizuar në masen 73%.

Realizimi i projektit Brigaid për vitin 2021 është në masën 64%. Fondet e mbetura të projektit janë trashëguar në vitin 2022.

### **-Monitorimi i performancës së buxhetit dhe raportimi i zbatimit të buxhetit**

Nga auditimi rezulton se, çdo 4 mujor nga strukturat përgjegjëse në Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit janë hartuar dhe përcjellë pranë MFE raportet e monitorimit.

AKPT ka realizuar sistematikisht monitorimin katër mujor të fondeve buxhetore. Buxheti është monitoruar dhe raportuar nga Struktura përkatëse pranë Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse në institucion për treguesit ekonomiko- financiar. Raportet e monitorimit janë dëgjuar në MFE, sipas kërkesave të kuadrit rregullator në fuqi.

Rakordimi lidhur me realizimin e zërave buxhetorë në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli është kryer në mënyrë periodike me Degën e Thesarit Tiranë. Ky është bërë mbi bazën

e urdhër shpenzimeve të plotësuara, miratuara, kontrolluara dhe likuiduara dhe të regjistruara në situacionet përkatëse të shpenzimeve.

*Për periudhën objekt auditimi nuk u konstatuan parregullsi në lidhje me monitorimin e buxhetit.*

### **Opinion i përgjithshëm mbi funksionimin e sistemit:**

Në përfundim të auditimit vlerësojmë se:

Për periudhën e audituar, në AKPT është ngritur sistemi i kontrollit për procesin e hartimit, miratimit dhe raportimit për monitorimin e zbatimit të buxhetit në përputhje me ligjin e Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjet vjetore të buxhetit dhe aktet përkatëse nënligjore. **Por**, nga grupi i auditimit është konstatuar se ky sistem për periudhën objekt auditimi ka mangësi në fazën e Programimit të buxhetit lidhur me planifikimin e disa artikujve buxhetorë të shpenzimeve për të cilët nuk është bërë i detajuar, nuk është argumentuar dhe nuk është mbështetur në dokumentacion të vlefshëm justifikues. **Risku për këtë sistem vlerësohet i mesëm.**

## **2. Sistemi i veprimeve dhe operacioneve me likuiditetet.**

### *Objektivi i auditimit:*

Vlerësimi nëse veprimet e kryera për arkëtimet dhe pagesat janë të mbështetura në dispozitat ligjore dhe të shoqëruara me dokumentacionin justifikues.

### *Fushat të cilat do të merren në konsideratë gjatë auditimit:*

- Rregullshmëria dhe ligjshmëria e veprimeve të kryera me anë të arkës dhe thesarit për periudhën objekt auditimi.
- Mbështetja e transaksioneve financiare dhe shpenzimeve me dokumentacionin vërtetues e justifikues.
- Rregullshmëria e dokumentimit në kontabilitet të këtyre veprimeve.

### *- Rregullshmëria dhe ligjshmëria e veprimeve të kryera me anë të arkës dhe thesarit për periudhën objekt auditimi.*

Për periudhën objekt auditimi, evidentohet se institucioni ka veprime minimale nëpërmjet arkës, në lekë, vetëm për paradhënie për shërbime.

Për vitin 2021 janë kryer gjithsej 9 veprime; nga të cilat 5 arkëtime dhe 4 pagesa.

Për vitin 2022 janë kryer gjithsej 19 veprime; nga të cilat 8 arkëtime dhe 11 pagesa.

Arkëtimet dhe pagesat me arkën në lekë janë përdorur vetëm për dieta.

Gjendja e arkës në lekë në fillim të çdo periudhe ushtrimore ka qënë 0 (zero).

Çdo muaj është mbajtur procesverbali inventarizimit të arkës, i cili është nënshkruar në çdo rast nga punonjësi që mban arkën dhe përgjegjësjë e finances dhe dokumentohet në librin e arkës sipas përcaktimeve të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, neni 80, ku citohet se: “Përcaktimi i gjëndjes së vlerave monetare në arkë dhe letrave me vlerë bëhet nga nëpunësi zbatues me anë të inventarizimit fizik minimalisht një herë në muaj”.

Në AKPT, transaksionet financiare janë kryer me bankë, nëpërmjet sistemit të thesarit.

Për periudhën e audituar, nëpërmjet bankës janë kryer 352 transaksione pagesash për vitin 2021 dhe 299 për vitin 2022,

Pagesat e kryera nëpërmjet thesarit, janë brenda fondeve disponibël të miratuara për periudhën ushtrimore 2021 dhe 2022.

Transaksionet financiare nëpërmjet sistemit të thesarit, për periudhën objekt auditimi, janë kryer me Urdhër Shpenzime që konsistojnë në:

- pagesa për paga, sigurime shoqërore e shendetësore, tatime mbi pagë etj.
- pagesa për shpenzime energji elektrike, ujë, shpenzime telefonike e postare etj.
- pagesa për kontrata të lidhura për shërbime të kryera riparime mirëmbajtje,
- pagesa për dieta dhe udhëtime;
- pagesa për likujdime faturash për blerje mallrash e shërbimesh etj.

Arka i është nënshtuar kontrollit të vazhdueshëm duke përpiluar në fund të çdo muaji procesverbalin e kontrollit të gjendjes fizike të arkës, ku është bërë krahasimi i gjendjes fizike me gjendjen kontabël.

Për sa më sipër, grupi i auditimit vlerëson se transaksionet dhe regjistrimet e veprimeve me arkë janë kryer në mënyrë kronologjike në ditarin përkatës, konform Ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar: Ligji nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; VKM nr.783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe të rregullave kontabël”, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat 61-72 të tij.

*- Mbështetja e transaksioneve financiare dhe shpenzimeve me dokumentacionin vërtetues e justifikues.*

Për çdo arkëtim dhe pagesë të kryer janë plotësuar mandat arkëtimet apo mandatpagesat përkatëse, të cilat janë me nr. rendor rritës, pa ndërprerje. Të gjitha veprimet janë regjistruar në librin e arkës në mënyrë kronologjike.

Dokumentacioni i arkës ka të bashkëlidhur në çdo rast dokumentacionin vërtetues e justifikues përkatës, si urdhër i brendshëm për shërbimin që do të kryhet, autorizimin, faturat tatimore, urdhër shpenzimi, mandat arkëtimin e bankës.

Cdo Urdhër Shpenzimi, për të gjitha transaksionet financiare të kryer nëpërmjet thesarit, i është bashkëlidhur i gjithë dokumentacioni mbështetës justifikues për shpenzimin e kryer.

*- Rregullshmëria e dokumentimit në kontabilitet të këtyre veprimeve.*

Të gjitha veprimet e kryera nëpërmjet arkës, janë regjistruar në librin e arkës në mënyrë kronologjike.

Të gjitha veprimet e kryera nëpërmjet thesarit janë regjistruar me korrektësi, në mënyrë kronologjike për çdo veprim ose ngjarje, i cili përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore.

Të gjitha transaksionet financiare janë të regjistruara në mënyrë kronologjike në ditarë dhe librat e kontabilitetit, si për vitin 2021 dhe 2022

Urdhër pagesat janë të përpiluara saktë dhe të plotësuara me të gjitha ekstremitetet e tyre, të nënshkruara nga personat përgjegjës dhe të vulosura nga Dega e Thesarit, Tiranë.

Janë kryer rakordime periodike dhe përfundimtare me Degën e Thesarit, Tiranë të cilat përputhen me kontabilitetin e institucionit.

## **Opinion i Përgjithshëm mbi funksionimin e sistemit:**

Grupi i auditimit vlerëson se:

-Transaksionet dhe regjistrimet e veprimeve me arkë dhe nëpërmjet thesarit janë kryer në mënyrë kronologjike në ditarin përkatës, konform Ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar; Ligji nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; VKM nr.783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe të rregullave kontabël”, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat 61-72 të tij.

Përsa më lart, vlerësojmë se risku për këtë sistem *vlerësohet i ulët*.

### **3. Rregullshmëria e hartimit të Planeve të Detyruara Vendore për 9 bashki: Durrës, Kamëz; Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Shijak, Vorë.**

*Objektivi i auditimit:*

Vlerësimi nëse procedurat e kryera janë në përputhje me aktet ligjore e neligjore në fuqi.

*Fushat të cilat do të merren në konsideratë gjatë auditimit:*

- Rregullshmëria e zbatimit të VKM nr.9 datë 10.01.2020 “Për caktimin e njësisve zbatuese për hartimin e planeve të detyruara vendore dhe financimin e tyre nga fondi për rindërtimin, miratuar në buxhetin e vitit 2020”.

- Dokumentimi i procedurave të këtij procesi, si dhe vlerësimi i ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së tij, për periudhën objekt auditimi.

*- Rregullshmëria e zbatimit të VKM nr.9 datë 10.01.2020 “Për caktimin e njësisve zbatuese për hartimin e planeve të detyruara vendore dhe financimin e tyre nga fondi për rindërtimin, miratuar në buxhetin e vitit 2020”.*

Me VKM nr.9 datë 10.01.2020, Agjencia Kombëtare e Planifimit të Territorit është ngarkuar si njësi zbatuese për hartimin e Planeve të Detyruara Vendore për 9 bashki: Durrës, Kamëz; Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Shijak dhe Vorë, të cilat janë prekur nga tërmeti i nëntorit 2019, duke i akorduar asaj dhe fondin prej 137.420.000 lekë për prokurimin e shërbimit të hartimit të këtyre planeve.

Planet e Detyruara Vendore janë hartuar për tre tipologji:

Plane të Detyruara Vendore për Zonat e Reja për Zhvillim;

Plane të Detyruara Vendore për Zona të Dëmtuara Pikësore, banesa individuale;

Plane të Detyruara Vendore për Zona të Dëmtuara Pikësore, banesa kolektive;

Zonat e Reja për Zhvillim janë miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave ndërsa Zonat e dëmtuara Pikësore janë miratuar rast pas rasti nga Komisioni Shtetëror i Rindërtimit (KSHR).

Në këtë kuadër, AKPT ka zhvilluar procedurën e prokurimit publik, menjëherë pas evidentimit të zonës së dëmtuar nga fatkeqësia natyrore.

Grupi i auditimit konstaton se procedurat e prokurimit për shërbimin e hartimit të Planeve të Detyruara Vendore janë audituar nga KLSH, sipas programit të auditimit nr.931/1, datë 14.09.2021 dhe raporti përfundimtar i auditimit është dërguar në AKPT në janar 2022.

Grupi i auditimit konstaton se fondet e papërdorura për hartimin e Planeve të Detyruara Vendore sipas VKM nr.9 datë 10.01.2020, janë trashëguar në vitet buxhetorë pasardhës.



Nga shqyrtimi i dokumentacionit shkresor, e konkretisht rregjistrit të realizimit të prokurimeve publike, grupi i auditimit konstaton se për vitin 2021: fondi i parashikuar për hartimin e Planeve të Detyruara Vendore ka qënë në shumën 39.960.342 lekë pa tvsh dhe 47.952.410 lekë me tvsh, i cili është realizuar në vlerën 21.733.553.8 lekë.

Për vitin 2022; fondi i parashikuar për hartimin e Planeve të Detyruara Vendore ka qënë në masën 21.849.047 lekë pa tvsh dhe 26.218.856 lekë me tvsh, i cili është realizuar në vlerën 3.438.000 lekë.

Grupi i auditimit konstaton dhe vlerëson se AKPT, në çdo rast, ka zbatuar përcaktimet e VKM nr.9 datë 10.01.2020 dhe vendimet e Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, duke marrë masa për kryerjen në kohë të prokurimeve për hartimin e planeve respektive.

*- Dokumentimi i procedurave të këtij procesi, si dhe vlerësimi i ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së tij, për periudhën objekt auditimi.*

Procedurat e prokurimit për hartimin e Planeve të Detyruara Vendore për zonat e dëmtuara; të kryera gjatë vitit 2021, janë bazuar në Ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar; Ligjin nr.97/2019 “Për miratimin e Aktit Normativ nr.9 datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqsive natyrore”, me fuqinë e ligjit: VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”; i ndryshuar: VKM nr.887 datë 24.12.2019, “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planeve të detyruara Vendore ... në rastet e fatkeqsive natyrore”; i ndryshuar: VKM nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”; dhe Vendimeve respektive të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit për çdo plan; Lloji i procedurës së prokurimit është përzgjedhur: “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, me formë shkresore”.

Grupi i auditimit shqyrtoi procedurat e prokurimit për hartimin e Planeve të Detyruara Vendore si më poshtë:

- Hartimi i Planeve të Detyruara Vendore për zonat e dëmtuara pikësore: 57 banesa individuale, Bashkia Shijak dhe Bashkia Kurbin si dhe 134 banesa individuale Bashkia Vorë;
- Hartimi i Planeve të Detyruara Vendore për zonat e dëmtuara pikësore 130 banesa individuale Bashkia Durrës; procedura këto të kryera gjatë vitit 2021 dhe
- Hartimi i Planeve të Detyruara Vendore për zonat e dëmtuara pikësore 6 banesa kolektive, Bashkia Durrës dhe 180 banesa individuale, Bashkia Shijak, Bashkia Kurbin dhe Bashkia Kamëz.
- Hartimi i Planeve të Detyruara Vendore për zonat e dëmtuara pikësore 50 apartamente në banesa kolektive, Bashkia Vorë; procedura këto të kryera gjatë vitit 2022.

*- Procedura e prokurimit: Hartimi i Planeve të Detyruara Vendore për zonat e dëmtuara pikësore: 57 banesa individuale, Bashkia Shijak dhe Bashkia Kurbin si dhe 134 banesa individuale Bashkia Vorë.*

Komisioni Shtetëror i Rindërtimit me Vendimin nr.70 datë 12.01.2021, ka miratuar rindërtimin në të njëjtin truall të 57 banesave individuale, Bashkia Shijak dhe Bashkia Kurbin si dhe të 134 banesave individuale në Bashkinë Vorë; si dhe ka përcaktuar AKPT-në; për të filluar punën për hartimin e PDyV-e për zonat e dëmtuara pikësore si më sipër;

Për këtë Njësia e Përhershme e Prokurimit, ngritur me Urdhërin nr.19 datë 27.01.2020, me nr.47/05 prot. të Titullarit të Autoritetit Kontraktues, i ndryshuar, me procesverbalin nr.83 datë 14.01.2021 ka hartuar termat e referencës, kriterëve të kualifikimit dhe përlllogaritjen e fondit limit, për procedurën e prokurimit me objekt “Hartimi i Planeve të Detyruara Vendore (PDyV) për zonat

e dëmtuara pikësore të: 57 banesave individuale, Bashkia Shijak dhe Bashkia Kurbin si dhe 134 banesave individuale Bashkia Vorë”.

Vlera totale e fondit limit të përlllogaritur është në vlerën 3,239.449 lekë, (pa tvsh), e ndarë për Hartimin e Planeve të Detyruara Vendore (PDyV) për zonat e dëmtuara pikësore 57 banesa individuale, Bashkia Shijak dhe Bashkia Kurbin në vlerën 1.150.234 lekë; dhe vlera totale e fondit limit për Hartimin e Planeve të Detyruara Vendore (PDyV) për zonat e dëmtuara pikësore 134 banesa individuale Bashkia Vorë në vlerën 2.089.215 lekë.

Me shkresën nr.83/1 datë 14.01.2021 ka dalë Urdhër Prokurimi nr.9. ku përcaktohet fondi limit; dy lotet me fondet limit respektivë; objekti i prokurimit për Hartimin e Planeve të Detyruara Vendore (PDyV) për zonat e dëmtuara pikësore të: 57 banesave individuale, Bashkia Shijak dhe Bashkia Kurbin si dhe 134 banesave individuale Bashkia Vorë; ndarë në dy lote; lloji i procedurës “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, me formë shkresore”, baza ligjore dhe Njësia e Prokurimit.

Me shkresat nr.83/4 – 83/13 prot. datë 14.01.2021, u janë dërguar ftesat për pjesëmarrje 10 subjekteve; për dorëzimin e ofertave të tyre pranë AKPT-së, më datë 18.01.2021, ora 16.00.

Sipas procesverbalit nr.83/23 date 18.01.2021 të KVO. rezulton se për lotin e parë janë paraqitur 4 ofertues dhe për lotin e dytë pesë ofertues.

Anëtarët e KVO kanë plotësuar formularin e deklarimit të konfliktit të interesit datë 18.01.2021.

Me procesverbalet nr.83/24 dhe 83/25 prot. datë 19.01.2021, KVO ka bërë vlerësimin e ofertave të paraqitura si dhe ka bërë përlllogaritjen e pikëve sipas kriterëve të vendosura duke renditur të parët operatorët me vlerën ekonomike më të vogël, me të cilët janë nënshkruar kontratat e shërbimit respektive, sipas loteve; respektivisht në vlerën 920.000 lekë pa tvsh për lotin e parë, fondi limit i të cilit ishte 1.150.234 lekë pa tvsh; dhe 1.600.000 lekë pa tvsh për lotin e dytë, fondi limit i të cilit ishte 2.089.215 lekë, pa tvsh.

*- Procedura e prokurimit: Hartimi i Planeve të Detyruara Vendore për zonat e dëmtuara pikësore: 130 banesa individuale, Bashkia Durrës.*

Njësia e Përhershme e Prokurimit, ngritur me Urdhërin nr.19 datë 27.01.2020, me nr.47/05 prot. të Titullarit të Autoritetit Kontraktues, i ndryshuar, me procesverbalin nr.166 datë 02.02.2021 ka hartuar termat e referencës, kriterëve të kualifikimit dhe përlllogaritjen e fondit limit, për procedurën e prokurimit me objekt “Hartimi i Planeve të Detyruara Vendore për zonat e dëmtuara pikësore: 130 banesa individuale, Bashkia Durrës”

Vlera totale e fondit limit të përlllogaritur është në shumën 2,049.426 lekë, pa tvsh.

Me procesverbalin nr.166/2 datë 02.02.2021; Njësia e Prokurimit ka hartuar dhe miratuar dokumentet e tenderit për këtë procedurë, me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës në formë shkresore, e cila është miratuar nga Titullari.

Me relacionin nr.166/3 datë 02.02.2021 është sugjeruar dërgimi i ftesave për pjesëmarrje për 10 operatorë ekonomike, relacion i cili është miratuar nga Titullari Autoritetit Kontraktues.

Formulari i ftesës për ofertë i është dërguar 10 operatorëve, ftesë e cila përmban: procedurën e prokurimit: “negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës në formë shkresore”;objektin, fondin limit, afatin për dorëzimin e ofertave data 04.02.2021, ora 15.30 si dhe kriteret e përzgjedhjes.

Sipas procesverbalit nr.166/19 date 04.02.2021 të KVO, rezulton se për këtë procedurë kanë dorëzuar ofertë pesë operatorë ekonomikë.

Me procesverbalin nr.166/20 datë 05.02.2021, KVO ka bërë vlerësimin e ofertave të paraqitura, duke kualifikuar 3 operatorë dhe ka skualifikuar dy operatore tjere me argumentin e perbashket se është i njëjti staf i cili është i angazhuar me kontrata të lidhura me AKPT-në; si dhe ka bërë

përlllogaritjen e pikëve për operatorët e kualifikuar, sipas kriterëve të vendosura duke renditur të parin operatorin UTS-01 me 97.91 pikë, me ofertë në vlerën 1.960.000 lekë pa tvsh. KVO ka hartuar raportin përmbledhës nr.166/21 datë 05.02.2021, duke propozuar njoftimin e fituesit, operatori UTS-01 i renditur i pari, raport i cili është miratuar nga titullari. Më datë 05.02.2021 është nënshkruar kontrata e shërbimit me operatorin UTS-01, me vlerë 1.960.000 lekë pa tvsh dhe 2.325.000 lekë me tvsh.

Grupi i auditimit konstaton se në cdo rast është bërë marrja në dorëzim e planeve të detyruara vendore, nga komisioni përkatës në AKPT e pas kësaj është bërë likudimi i faturës tatimore, në zbatim të kontratës së nënshkruar.

Planet e Detyruara Vendore për zonat e dëmtuara, gjenden të publikuara me miratimet nga Kryetarët e bashkive përfituese të këtyre planeve: në zbatim të VKM Nr.887, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore" apo vendimeve respektive të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit dhe akteve të tjera në fuqi.

Për vitin 2022.

Procedurat e prokurimit për hartimin e Planeve të Detyruara Vendore për zonat e dëmtuara; të kryera gjatë vitit 2022, janë bazuar në Ligjin nr.162 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" dhe VKM nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"; VKM nr.887, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe .... në rastet e fatkeqësisë natyrore"; i ndryshuar; VKM nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim"; Vendimet respektive të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit etj.

Lloji i procedurës së prokurimit është përzgjedhur: "Marrëveshje kuadër, në kuadër të procesit të rindërtimit me procedurë të përshpejtuar".

*Procedura e prokurimit: - Hartimi i Planeve të Detyruara Vendore për zonat e dëmtuara pikësore 6 banesa kolektive, Bashkia Durrës dhe 180 banesa individuale. Bashkia Shijak, Bashkia Kurbin dhe Bashkia Kamëz.*

Sipas relacionit nr.554 datë 18.03.2022, nga personi përgjegjës për prokurimet në AKPT; caktuar me Urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr.1 datë 05.01.2022; është sugjeruar që të përdoret procedura e prokurimit: "Marrëveshje kuadër, në kuadër të procesit të rindërtimit me procedurë të përshpejtuar", relacion i cili është miratuar nga Titullari i AKPT-së.

Me shkresën nr.554/1 datë 18.03.2022, ka dalë Urdhëri nr.30: "Për ngritjen e njësisë së prokurimit për procedurën e prokurimit "Marrëveshje kuadër, në kuadër të procesit të rindërtimit me procedurë të përshpejtuar"; ku janë caktuar tre punonjës.

Me shkresën nr.554/2 datë 18.03.2022, ka dalë Urdhëri nr.31: "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e termave të referencës, kriterëve të kualifikimit përsa i përket kapacitetit teknik dhe përgatitjen e materialit G.I.S. për këtë procedurë prokurimi, me tre anetare, dy specialist nga Drejtoria e Projekteve dhe Kerkimit Shkencor dhe një specialist nga Drejtoria e G.I.S. për planifikimin e teritorit..

Me procesverbalin nr.554/3, datë 24.03.2022, grupi i punës ka hartuar termat e referencës, kriteret e kualifikimit përsa i përket kapacitetit teknik dhe përgatitjen e materialit G.I.S. për dy lote: loti i parë: Hartimi i Planeve të Detyruara Vendore për zonat e dëmtuara pikësore 6 banesa kolektive,

Bashkia Durrës dhe Loti i dytë: Hartimi i Planeve të Detyruara Vendore për zonat e dëmtuara pikësore 180 banesa individuale, Bashkia Shijak, Bashkia Kurbin dhe Bashkia Kamëz.

Me procesverbalin nr.554/4, datë 24.03.2022, grupi i punës ka bërë përlogaritjen e fondit limit për Lotin I: Hartimi i Planeve të Detyruara Vendore për zonat e dëmtuara pikësore 6 banesa kolektive, Bashkia Durrës, në vlerën 1.195.288 lekë, pa tvsh.

Me procesverbalin nr.554/4, datë 24.03.2022, grupi i punës ka bërë përlogaritjen e fondit limit për Lotin II: Hartimi i Planeve të Detyruara Vendore për zonat e dëmtuara pikësore 180 banesa individuale, Bashkia Shijak, Bashkia Kurbin dhe Bashkia Kamëz, në vlerën 2.382.245 lekë, pa tvsh.

Me shkresën nr.554/6 datë 24.03.2022, ka dalë Urdhër Prokurimi nr.19, për prokurimin e fondit limit 3.577.534 lekë, pa tvsh; me objekt Hartimi i Planeve të Detyruara Vendore, me dy lote; lloji i procedurës: Procedurë e përshpejtuar. Marrëveshje kuadër, në kuadër të procesit të rindërtimit, duke caktuar dhe njësinë e prokurimit të përbërë nga 3 punonjës.

Me procesverbalin nr.554/7 datë 25.03.2022 Njësia e Prokurimit ka argumentuar dhe miratuar specifikimet teknike dhe kriteret për kualifikim për lotin I dhe me procesverbalin nr.554/8 datë 25.03.2022 Njësia e Prokurimit ka argumentuar dhe miratuar specifikimet teknike dhe kriteret për kualifikim për lotin II.

Me procesverbalin nr.554/9 datë 25.03.2022, Njësia e Prokurimit ka hartuar dhe miratuar dokumentet e tenderit për procedurën Marrëveshje kuadër, me procedurë të përshpejtuar, në kuadër të procesit të rindërtimit.

Me shkresën nr.554/10 datë 25.03.2022, është bërë njoftimi i kontratës për lotin I dhe me shkresën nr.554/11 datë 25.03.2022, është bërë njoftimi i kontratës për lotin II, duke përcaktuar kohëzgjatjen e kontratës, afatin kohor për ekzekutim si dhe afatin për dorëzimin e ofertave, data 7.04.2022, ora 10.00; për të dy lotet.

Me shkresën nr.554/12 datë 25.03.2022, Titullari i AK ka nxjerrë Urdhërin nr.35, për ngritjen e KVO për këtë procedurë.

KVO, me procesverbalin nr.554/13 datë 07.04.2022, ka bërë hapjen e ofertave dhe ka konstatuar se për lotin I kanë marrë pjesë dy ofertes: NET GROUP dhe UTS-01; dhe me procesverbalin nr.554/14 datë 07.04.2022, ka bërë hapjen e ofertave dhe ka konstatuar se për lotin II ka marrë pjesë një ofertes, NET GROUP.

KVO, sipas procesverbalit nr.554/15 datë 11.04.2022 ka bërë vlerësimin e kërkesave për shprehje interesi të paraqitura operatorët ekonomikë për lotin I dhe në përfundim, ka vendosur kualifikimin e të dy operatorëve; dhe sipas procesverbalit nr.554/16 datë 11.04.2022 ka bërë vlerësimin e kërkesave për shprehje interesi të paraqitura operatorët ekonomikë për lotin II dhe në përfundim, ka vendosur kualifikimin e operatorit të vetëm të paraqitur.

KVO, ka hartuar raportin përmbledhës për titullarin, protokolluar nr.554/18 datë 14.04.2022; ku ka përshkruar veprimet e kryera dhe sugjerimet respektive, raport i cili është miratuar nga Titullari.

Me shkresën nr.554/19 datë 11.04.2022, është publikuar formulari i njoftimit të operatorëve të suksesshëm për Lotin I dhe me shkresën nr.554/20 datë 11.04.2022, është publikuar formulari i njoftimit të operatorëve të suksesshëm për Lotin II.

Me shkresat nr.554/21 prot; nr.554/22 prot. dhe nr.554/23 prot. datë 19.04.2022 janë administruar dokumentacioni i paraqitur nga ofertesit pjesëmarrës të shpallur të suksesshëm.

KVO, sipas procesverbalit nr.554/24 datë 21.04.2022, ka bërë verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga subjektet dhe ka konstatuar se ai është origjinal, i noterizuar dhe identik me dokumentet e paraqitura në sistemin elektronik të prokurimit, për Lotin I dhe sipas procesverbalit nr.554/25 datë 21.04.2022, ka bërë verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti për Lotin II dhe ka konstatuar se ai është origjinal, i noterizuar dhe identik me dokumentet e paraqitura në sistemin elektronik të prokurimit.

Sipas shkresave nr.554/26 dhe 554/27, datë 27.04.2022, janë nënshkruar draft marrëveshjet kuadër për Lotin I me dy operatorë dhe sipas shkresës nr. 554/28 datë 27.04.2022 është nënshkruar draft marrëveshja për lotin II.

Me shkresën nr.554/29 datë 27.04.2022, është bërë ftesa për ofertë për Lotin II, duke përcaktuar kohëzgjatjen e shërbimit 20 ditë; kriteret e kualifikimit si dhe afatin e paraqitjes së ofertës datë 04.05.2022, ora 10.00.

Me shkresën nr.554/31 datë 04.05.2022; është bërë dorëzimi i ofertës dhe dokumentacioni shoqërues për Lotin II.

KVO, sipas procesverbalit nr.554/32 datë 04.05.2022, ka bërë hapjen dhe ofertës, e cila është në vlerën 2.380.000 lekë pa tvsh, nga 2.382.245 lekë që ishte fondi limit dhe sipas procesverbalit nr.554/33 datë 05.05.2022 ka bërë vlerësimin e ofertës me 93.33 pikë.

Me shkresën nr.554/34 datë 05.05.2022: është bërë formulari i njoftimit të ofertës.

Me shkresën nr.554/35 datë 06.05.2022: është dërguar në APP formulari i njoftimit të fituesit, për publikim.

Me shkresën nr.554/36 datë 16.05.2022: është bërë nënshkrimi i kontratës për lotin e dytë të kësaj procedurë prokurimi Hartimi i Planeve të Detyruara Vendore për zonat e dëmtuara pikësore 180 banesa individuale, Bashkia Shijak, Bashkia Kurbin dhe Bashkia Kamëz, me operatorin NET-GROUP, me vlerë 2.380.000 lekë.

Lidhur me ecurinë e lotit I, grupi i auditimit konstaton se procedurat janë anuluar pas kërkesës së bërë nga bashkia Durrës dhe vendimit të Komisioni Shtetëror i Rindërtimit, i cili me Vendimin nr.104 datë 08.07.2022, pika 26 e tij ka vendosur: "Të miratojë shfuqizimin e ... ; dhe pikës 5 të Vendimit nr.100 datë 07.03.2022 të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit dhe akomodonin e nevojës, në njësitë e banimit të financuara për rindërtim, bazuar në shkresën nr.3811/1 datë 18.05.2022 të Bashkisë Durrës";

*Procedura e prokurimit: - Hartimi i Planeve të Detyruara Vendore për zonat e dëmtuara pikësore 50 apartamente në banesa kolektive, Bashkia Vorë.*

Titullari i A.K. ka nxjerrë Urdherin nr.65 datë 13.07.2022, prot nr.1087 "Për ngritjen e njësisë së prokurimit për procedurën e prokurimit: Marrëveshje kuadër, në kuadër të procesit të rindërtimit me procedurë të përshpejtuar" për Hartimin e Planeve të Detyruara Vendore për zonat e dëmtuara pikësore 50 apartamente në banesa kolektive, Bashkia Vorë.

Me procesverbalin nr.1087/1, datë 15.07.2022, Njësia e prokurimit ka hartuar termat e referencës, kriteret e vecanta të kualifikimit përsa i përket kapacitetit teknik dhe përlllogaritjen e fondit limit në vlerën 436.982 lekë pa tvsh.

Me shkresën nr.1087/2 datë 15.07.2022, ka dalë Urdhër Prokurimi nr.41, për prokurimin e fondit limit 436.982 lekë, pa tvsh; me objekt Hartimi i Planeve të Detyruara Vendore për zonat e dëmtuara pikësore 50 apartamente në banesa kolektive, Bashkia Vorë, duke caktuar dhe njësinë e prokurimit për zbatimin e udhërit.

Me procesverbalin nr.1087/3 datë 15.07.2022 Njesia e Prokurimit ka argumentuar dhe miratuar specifikimet teknike dhe kriteret për kualifikim për efekt publikimi, i cili është miratuar nga Titullari i AK, duke përcaktuar afatin për dorëzimin dhe hapjen e ofertave datën 01.08.2022, ora 10.00.

Me shkresën nr.1087/4 datë 15.07.2022, Titullari i AK ka nxjerrë Urdhërin nr.66, për ngritjen e KVO për këtë procedurë, i cili ka ndryshuar me Urdherin nr.66/1, prot. nr.1087/5, datë 01.08.2022. KVO, me procesverbalin nr.1087/6 datë 01.08.2022, ka bërë hapjen e ofertave dhe ka konstatuar se janë paraqitur tre subjekte.

KVO, me procesverbalin nr.1087/7 datë 05.08.2022, ka konstatuar një gabim në dokumentet e tenderit lidhur me disponimin e stafit nga konsulentet dhe ka sugjeruar anulimin e procedurës.

Me shkresën nr.1087/8 datë 5.08.2022 është dërguar formulari i njoftimit të anulimit të procedurës. Me procesverbalin nr.1087/9 datë 5.08.2022, Njësia e Prokurimit ka argumentuar dhe miratuar specifikimet teknike dhe kriteret për kualifikim për efekt publikimi, duke bërë rregullimet përkatëse: si dhe njoftimi i kontratës; duke përcaktuar afatin për dorëzimin dhe hapjen e ofertave datën 26.08.2022, ora 10.00.

Me shkresën nr.1087/10 datë 24.08.2022. Titullari i AK ka nxjerrë Urdhërin nr.66/2, për ndryshim në përbërjen e KVO.

KVO, me procesverbalin nr.1087/11 datë 26.08.2022. ka bërë hapjen e ofertave dhe ka konstatuar se janë paraqitur katër subjekte.

KVO, me procesverbalin nr.1087/12 datë 29.08.2022, ka bërë vlerësimin e kërkesave për shprehje interesi të paraqitura operatorët ekonomikë dhe ka vendosur kualifikimin e të tre operatorëve: NET GROUP; UTS-01 dhe BOE Illyrian Consulting Engineeris + Architectural Gate si dhe ka skualifikuar një operator: BOE ATRIA STUDIO + IVA BOGDAAN, pasi deklarata për plotësimin e kriterëve të përgjithshme është plotësuar vetëm nga njëri subjekt; si dhe deshmite e mëparshme janë paraqitur vetëm nga një subjekt.

KVO, ka hartuar raportin përmbledhës për titullarin, protokolluar nr.1087/13 datë 01.09.2022; ku ka përshkruar veprimet e kryera; bazën ligjore; subjektet e kualifikuara dhe ato të skualifikuara, duke propozuar miratimin e raportit për fazën I dhe nënshkrimin e Marrëveshjes kuadër me operatorët e suksesshëm, raport i cili është miratuar nga Titullari.

Me shkresën nr.1087/14 datë 1.09.2022, është dërguar formulari i njoftimit të operatorëve të suksesshëm në marrëveshjen kuadër.

Sipas shkresave nr.1087/19; 1087/20; dhe 1087/21 datë 08.07.2022, janë nënshkruar draft marrëveshjet kuadër me tre operatorët e suksesshëm për këtë procedurë prokurimi.

Me shkresën nr.1087/22 datë 09.09.2022, u është dërguar subjekteve të mësipërme ftesa për ofertë, të cilat duhet të paraqiten pranë AKPT-së brenda daës 15.09.2022 ora 16.00; si dhe kriteret e vlerësimit të ofertës fituese.

Me shkresën nr.1087/23 datë 13.09.2022. Titullari i AK ka nxjerrë Urdhërin nr.66/3, për ndryshim në përbërjen e KVO.

Me shkresat nr.1087/24–1087/26 datë 15.09.2022; është bërë dorëzimi i ofertave dhe dokumentave nga operatorët me të cilët janë nënshkruar draft marrëveshjet kuadër.

KVO, me shkresën nr.1087/27 datë 20.09.2022, ka kërkuar sqarime nga operatori Net Group për oferten e paraqitur e cila është anomalisht e ulët, i cili ka kthyer përgjigje për sqarimin e ofertës.

Me shkresën 1087/31 datë 27.09.2022 është bërë njoftimi i fituesit operatorit UTS-01, me ofertë 408.000 lekë pa tvsh, me të cilin është nënshkruar kontrata për shërbimin e kërkuar.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përlllogaritjes së fondit limit, i cili bazohet në tarifën e përcaktuara në VKM nr.354 datë 11.05.2016, “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”, grupi i auditimit konstaton se përlllogaritjet e fondit limit janë bërë jo në përputhje me kërkesat e VKM nr.354 datë 11.05.2016, Konkretisht, sipas nenit 7 të VKM nr.354 datë 11.05.2016 “Përcaktimi i tarifave” pika 1; thuhet: *“Tarifa për shërbimet duhet të jetë një vlerë ndërmjet tarifave minimale dhe maksimale, të përcaktuara në këtë manual, në përputhje me ligjin e prokurimit publik”*; pasi nuk janë përlllogaritur vlerat mesatare, por për procedurat e kryera gjatë vitit 2021, janë marrë tarifën maksimale.

Për rastet e trajtuara më sipër, grupi i auditimit konstaton se nga grupi i punës për përlllogaritjen e fondit limit, si për llogaritjen vlerës totale të projektimit; për hartimin e PdyV-së; për shërbimet e studimeve të ndikimit në mjedis dhe shërbimet topografike të kryera, për prokurimet e kryera gjatë vitit 2021, janë marrë për bazë vlerat maksimale, ndërsa për përlllogaritjen e vlerës totale të

projektimit për hartimin e PdyV-së; tarifat për ndërtime të reja dhe ndarjet dhe shërbimet topografike; për prokurimet e kryera gjatë vitit 2022, janë marrë për bazë vlerat mesatare, duke zbatuar drejt kërkesat e nenit 7 të VKM nr.354 datë 11.05.2016; apo dhe nuk janë zbatuar drejt kërkesat e nenit 13 për interpolimin të VKM nr.354 datë 11.05.2016 (shih procesverbalet nr.83 prot. datë 14.01.2021; nr.166 prot. datë 02.02.2021; nr.554/04 datë 24.03.2022 dhe nr.1087/01 datë 15.07.2022);

**Titulli i Gjetjes:** Rregullshmëria e përcaktimit të fondit limit për prokurimet e kryera për Hartimin e Planeve të Detyruara Vendore për zonat e dëmtuara pikësore.

<b>Nr. i gjetjes: 2</b>	
<b>Subjekti i Audituar</b>	AKPT, Tiranë.
<b>Njësitë/Subjektet e interesuar nga gjetja</b>	AKPT, Tiranë. MIE.
<b>Përmbledhja e bazës ligjore</b>	VKM nr.354, datë 11.5.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyerje dhe kolaudim", i ndryshuar.
<b>Përshkrimi i gjetjes:</b>	<p><b>Situata:</b> Përcaktimi i fondit limit për procedurat e prokurimit <i>Hartimi i Planeve të Detyruara Vendore për zonat e dëmtuara pikësore</i>, nuk është kryer në përputhje me kërkesat e nenit 7, të VKM nr.354, datë 11.5.2016, i ndryshuar, "Përcaktimi i tarifave" 1. Tarifa për shërbimet duhet të jetë një vlerë ndërmjet tarifave minimale dhe maksimale, të përcaktuara në këtë manual, në përputhje me ligjin e prokurimit publik: dhe kërkesave të nenit 13 "Interpolimi" Tarifat minimale dhe maksimale të lejuara, për pikë të ndërmjetme të kostove të llogaritshme, vlerave dhe/ose njësisive të llogaritjes, të përcaktuara në rreshtat e tabelave të tarifave, duhet të llogariten me interpolim linear.</p> <p>Nga auditimi është konstatuar se grupi i punës për përlllogaritjen e fondit limit, si për llogaritjen vlerës totale të projektimit; për hartimin e PdyV-së; për shërbimet e studimeve të ndikimit në mjedis dhe shërbimet topografike të kryera, për prokurimet e kryera gjatë vitit 2021, edhe pse ka referuar nenin 7 të VKM nr.354, datë 11.5.2016; janë marrë për bazë vlerat maksimale, ndërsa për përlllogaritjen e vlerës totale të projektimit për hartimin e PdyV-së; tarifat për ndërtime të reja dhe ndarjet dhe shërbimet topografike; për prokurimet e kryera gjatë vitit 2022, janë marrë për bazë vlerat mesatare, duke zbatuar drejt kërkesat e nenit 7 të VKM nr.354 datë 11.05.2016.</p> <p>Për përlllogaritjen e fondit limit për hartimin e PdyV-së sipas procesverbalit nr.1087/01 datë 15.07.2022, nuk është përdorur formula e interpolimit sipas nenit 13 të VKM nr.354 datë 11.05.2016, por është marrë vlera minimale për sipërfaqen 0.5 ha, kur sipërfaqja në fakt është 0.1780 ha. (shih procesverbalet nr.83 datë 14.01.2021; nr.166 datë 02.02.2021; nr.554/04 datë 24.03.2022 dhe nr.1087/01 datë 15.07.2022).</p>

	<p><b>Kriteri:</b> VKM nr.354, datë 11.5.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyerje dhe kolaudim”, i ndryshuar, neni 7 dhe neni 13.</p> <p><b>Ndikimi/efekti:</b> Përcaktimi i drejtë i fondit limit për prokurimet, lidhet me përdorimin me efektivitet, efëcence dhe ekonomi të fondeve buxhetore.</p> <p><b>Shkaku:</b> Mosbatimi i kërkesave ligjore të përcaktuara në VKM nr.354, datë 11.5.2016.</p>
<b>Vlerësimi i nivelit të riskut</b>	I mesëm.
<b>Konkluzioni:</b>	Nuk janë ndjekur dhe zbatuar procedurat e parashikuara në VKM 354/2016. për përcaktimin e fondit limit, për prokurimet e kryera për Hartimin e Planeve të Detyruara Vendore për zonat e dëmtuara pikësore.
<b>Rekomandimi:</b>	Të merren masat e duhura që në të gjitha rastet e perlllogaritjes së fondit limit për prokurime, fondi limit/tarifë për shërbimet duhet të jetë një vlerë ndërmjet tarifave minimale dhe maksimale, të përcaktuar në manual. në përputhje me ligjin e prokurimit publik.
<b>Afati i fundit për zbatimin e rekomandimeve</b>	Menjëherë dhe në vazhdimësi.
<b>Statusi i rekomandimit</b>	Për tu kompletuar në kohën e hartimit të Raportit Përfundimtar.

#### **Opinion i Përgjithshëm mbi funksionimin e sistemit:**

Në përfundim të auditimit vlerësojmë se në procedurat e prokurimit për Hartimin e Planeve të Detyruara Vendore për zonat e dëmtuara pikësore, janë konstatuar të meta e parregullsi që çenojnë funksionimin e komponentëve të kontrollit të brendshëm. Komponentet e kontrollit të brendshëm në këtë sistem nuk janë vlerësuar nga niveli më i lartë i menaxhimit. gjë që ka çuar në kryerjen e veprimtarisë jo në përputhje me dispozitat ligjore.

Nga auditimi është konstatuar se grupi i punës për përlllogaritjen e fondit limit, si për llogaritjen vlerës totale të projektimit; për hartimin e PdyV-së; për shërbimet e studimeve të ndikimit në mjedis dhe shërbimet topografike të kryera, për prokurimet e kryera gjatë vitit 2021, edhe pse ka referuar nenin 7 të VKM nr.354, datë 11.5.2016: janë marrë për bazë vlerat maksimale, ndërsa për përlllogaritjen e vlerës totale të projektimit për hartimin e Pdy V-së; tarifat për ndërtime të reja dhe ndarjet dhe shërbimet topografike: për prokurimet e kryera gjatë vitit 2022, janë marrë për bazë vlerat mesatare, duke zbatuar drejt kërkesat e nenit 7 të VKM nr.354 datë 11.05.2016.

Për përlllogaritjen e fondit limit për hartimin e PdyV-së sipas procesverbalit nr.1087/01 datë 15.07.2022, nuk është përdorur formula e interpolimit sipas nenit 13 të VKM nr.354 datë 11.05.2016, por është marrë vlera minimale për sipërfaqen 0.5 ha. kur sipërfaqja në fakt është 0.1780 ha.

*Për sa më lart, grupi i auditimit vlerëson se kontrolli i brendshëm nuk ka funksionuar në të gjitha hallkat e këtij sistemi. Risku vlerësohet i mesëm.*



#### 4. Sistemi i procedurave të prokurimit të fondeve publike.

##### *Objektivi i auditimit:*

Vlerësimi nësë janë programuar dhe realizuar procedurat e prokurimit të fondeve publike për investime e shërbime në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

##### *Fushat të cilat do të merren në konsiderate gjatë auditimit:*

- Programimi i fondeve për investime apo blerje/shërbime, në përputhje me nevojat e institucionit.
- Rregullshmëria e realizimit të procedurave të prokurimit publik.
- Rregullshmëria e procedurave për realizimin e blerjeve dhe respektimi i fondit limit.
- Rregullshmëria e lidhjes dhe zbatimit të kontratave.

- *Programimi i fondeve për investime apo blerje/shërbime, në përputhje me nevojat e institucionit.*  
Për periudhën objekt auditimi, në zbatim të ligjit nr.9643/2006, "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar; ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik"; VKM nr.914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar; si dhe VKM nr.285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", janë hartuar dhe dërguar në APP dhe organin epror regjistrat e parashikimeve të prokurimeve publike dhe regjistrat e realizimit të prokurimeve publike për vitet 2021 dhe 2022; në përputhje me Udhëzimin e APP nr.1 datë 05.01.2018 dhe Udhëzimin e APP nr.4 datë 18.06.2021 "Për hartimin e regjistrat të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrat të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik".

Regjistri i parashikimeve të prokurimeve publike si për vitin 2021 dhe 2022, kanë pësuar ndryshime; të cilat në çdo rast kanë qënë të argumentuara mbi shkaqet dhe domosdoshmërinë e ndryshimeve të kryera dhe janë publikuar në sistemin elektronik të prokurimeve, të cilat në çdo rast janë dërguar në formë shkresore dhe CD në organin epror MI E dhe Degën e Thesarit, Tiranë, mbështetur në pikën 7 të Udhëzimit të APP nr.1, datë 05.01.2018 "Për hartimin e regjistrat të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrat të realizimit të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik".

Sipas regjistrat të parashikimeve të prokurimeve për vitin 2021, me gjithë ndryshimet e bëra janë parashikuar 37 objekte prokurimi që kanë të bëjnë me blerje mallash e shërbimesh; nga të cilat 32 objekte janë parashikuar blerje me vlera të vogla, dhe gjashtë janë parashikuar si procedura për shërbim konsulence, "Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, me formë shkresore".

Sipas regjistrat të realizimit të prokurimeve publike të vitit 2021, dërguar në MFE me shkresën nr.109 prot datë 19.01.2022, rezulton se janë kryer 26 objekte prokurime për blerja mallrash e shërbime, për të cilat janë kryer 33 procedura prokurim me vlerë të vogël dhe tre prokurime për zërin investime që kanë të bëjnë me blerje pajisje informatike me procedurë me vlerë të vogël, dhe dy prokurime për zërat "Planifikimi i modeleve të zhvillimit të 100 fshatrave" dhe "hartimi i planeve të detyruara vendore"; me procedurën shërbim konsulence.

Sipas regjistrat të parashikimeve të prokurimeve për vitin 2022, me gjithë ndryshimet e bëra janë parashikuar 31 objekte prokurimi që kanë të bëjnë me blerje mallash e shërbimesh; dhe 6 procedura për investime.

Sipas regjistrat të realizimit të prokurimeve publike të vitit 2022, dërguar në MFE me shkresën nr.114 prot. datë 24.01.2023, rezulton se janë realizuar 28 objekte prokurimi për blerja mallrash e shërbime për të cilat janë kryer 39 procedura prokurim me vlerë të vogël; 14 procedura blerje

me vlerë nën 100.000 lekë si dhe pesë prokurime për zërin investime që kanë të bëjnë me blerje pajisje informatike dhe pajisje zyre për të cilat janë zhvilluar gjashtë procedura me vlerë të vogël, dy prokurime për zërat “Planifikimi i modeleve të zhvillimit të 100 fshatrave” dhe “Hartimi i planeve të detyruara vendore”, me procedurën shërbim konsulence; dhe një prokurim blerje automjeti me procedurë të hapur të thjeshtuar.

Grupi i auditimit konsaton se për periudhën objekt auditimi, është bërë raportimi i realizimit të prokurimeve të kryera çdo katër muaj si dhe raportimi vjetor, brenda afatave të parashikuara në nenin 4 të VKM nr.285, datë 19.5.2021.

Prokurimi i fondeve për mallra dhe shërbime, për periudhën objekt auditimi, sipas procedurave respektive, janë parashikuar me burim financimi nga fondet e buxhetit të shtetit dhe grante.

AKPT, çdo katër muaj, ka bërë dorëzimin të informacioneve respektive në organet qendrore, për procedurat e prokurimit të realizuara, në zbatim të VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenit 4 të tij.

- *Rregullshmëria e realizimit të procedurave të prokurimit publik.*

- *Rregullshmëria e procedurave për realizimin e blerjeve dhe respektimi i fondit limit.*

- *Rregullshmëria e lidhjes dhe zbatimit të kontratave.*

#### **Procedura e hapur e prokurimeve**

Gupi i auditimit konstaton se sipas rregjistrave të realizimit të prokurimeve për periudhën objekt auditimi është zhvilluar vetëm një një procedurë e hapur, gjatë vitit 2022 konkretisht procedura për blerje automjeti.

*Procedura e prokurimit: "Blerje automjeti", me fond limit në shumën 3.166.666 lekë pa tvsh.*

Me shkresën nr.263, datë 03.02.2022, Drejtoria e Projekteve dhe Kërkimit Shkencor dhe Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, kanë paraqitur kërkesën për "Blerje automjeti", nga fondi BRIGAD në llogari të AKPT-së, kërkesë e cila është miratuar nga Titullari i institucionit, i cili me shkresën nr.263/1 datë 3.2.2022 ka nxjerrë Urdhërin nr.11 për ngritjen e njësisë së prokurimit për blerjen e një automjeti.

Njësia e Prokurimit, me shkresën nr.263/2, datë 10.02.2022, ka hartuar specifikimet teknike kriteret e kualifikimit si dhe ka përcaktuar fondin limit, në shumën 3.166.666 lekë, pa tvsh, duke u bazuar në tre oferta. Bashkëlidhur këtij relacioni janë edhe ofertat përkatëse.

Titullari i Autoritetit Kontraktor; ka nxjerrë Urdhërin e Prokurimit nr.13, datë 18.02.2022, prot nr.263/3; për blerje automjeti, në të cilin është përcaktuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me fond limit në shumën 3.166.666 lekë pa tvsh; si dhe është ngritur Njësia e Prokurimit, me tre anëtarë.

Me procesverbalin nr.263/4 datë 18.02.2022, Njësia e Prokurimit ka hartuar dhe miratuar dokumentat standarde të tenderit, kriteret e vlerësimit si dhe kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta të kualifikimit, i cili është miratuar nga Titullari.

Me shkresën nr.263/5, datë 18.02.2022 është bërë njoftimi i kontratës ku është përcaktuar afati për paraqitjen dhe hapjen e ofertave data 03.03.2022 ora 10.00.

Me shkresën nr.263/6, datë 18.02.2022, Titullari i Autoritetit Kontraktor ka nxjerrë Urdhërin nr.15, ku ka përcaktuar ngritjen e KVO për këtë procedurë prokurimi.

Me shkresën nr.263/7, datë 24.02.2022, Njësia e Prokurimit ka hartuar relacionin për hartimin e shtojcës për dokumentet standarde të tenderit, pas sugjerimit të kordinimit të APP-së, për shmangien e kriterëve që mund të vendosin barriera dhe pengesa në hyrje në tregun e prokurimeve duke propozuar hartimin e shtojcës për dokumentet e tenderit me sqarimet përkatëse si dhe pezullimin e procedurës së prokurimit deri në ngarkimin e shtojcës me ndryshime në dokumentet e tenderit, e cila është miratuar nga Titullari.

Me shkresën nr.263/8, datë 24.02.2022. paraqiten ndryshimet e bëra nga Njësia e Prokurimit, të miratuara nga Titullari.

Me shkresën nr.263/9, datë 24.02.2022 është bërë njoftimi i shkurtuar i kontratës ku është përcaktuar afati për paraqitjen dhe hapjen e ofertave data 03.03.2022 ora 10.00.

KVO, sipas procesverbalit nr.263/10, datë 03.03.2022, ka bërë hapjen e ofertave ku ka rezultuar se është paraqitur vetëm një operator ekonomik (Classic).

Anëtarët e KVO kanë plotësuar formularët e deklaramit të konfliktit të interesit, datë 03.03.2022.

KVO, sipas procesverbalit nr.263/11, datë 08.03.2022, ka bërë shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së vetme të paraqitur ku ka konstatuar mospërputhje të vlerës së shënuar me shifra, 3.160.000 lekë pa tvsh dhe me fjalë 8.160.000 lekë, duke refuzuar ofertën, bazuar në nenin 82 të VKM nr.285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

KVO, me shkresën nr.263/12, datë 15.03.2022, ka hartuar raportin përmbledhës, duke propozuar anulimin e procedurës, raport i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor.

Me procesverbalin nr.263/13 datë 18.05.2022, Njësia e Prokurimit ka hartuar specifikimet teknike, kriteret e kualifikimit si dhe ka përcaktuar fondin limit, në shumën 3.066.848 lekë, pa tvsh, duke u bazuar në tre oferta.

Titullari i Autoritetit Kontraktor; ka nxjerrë Urdhërin e Prokurimit nr.32, datë 19.05.2022, prot nr.263/14; për blerje automjeti, në të cilin është përcaktuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me fond limit në shumën 3.066.848 lekë pa tvsh; si dhe është ngritur Njësia e Prokurimit, me tre anëtarë.

Me procesverbalin nr.263/15 datë 20.05.2022, Njësia e Prokurimit ka hartuar dhe miratuar dokumentat standarde të tenderit, kriteret e vlerësimit si dhe kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta të kualifikimit, i cili është miratuar nga Titullari.

Me shkresën nr.263/16, datë 20.05.2022 është bërë njoftimi i shkurtuar i kontratës ku është përcaktuar afati për paraqitjen dhe hapjen e ofertave data 02.06.2022 ora 10.00.

KVO, sipas procesverbalit nr.263/17, datë 02.06.2022, ka bërë hapjen e ofertave ku ka rezultuar se është paraqitur vetëm një operator ekonomik (Albania Motor Company).

KVO, sipas procesverbalit nr.263/18, datë 02.06.2022, ka bërë shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së vetme të paraqitur ku ka konstatuar se operatori nuk ka paraqitur asnjë dëshmi për realizimin e kontratave të mëparshme duke vendosur refuzimin e ofertës.

KVO, me shkresën nr.263/22, datë 09.06.2022, ka hartuar raportin përmbledhës, duke propozuar anulimin e procedurës, raport i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor.

Me shkresën nr.263/23, datë 09.06.2022, është dërguar formulari i njoftimit të anulimit të procedurës.

Titullari i Autoritetit Kontraktor; ka nxjerrë Urdhërin e Prokurimit nr.13/1, datë 10.06.2022, prot nr.263/24; për blerje automjeti, në të cilin është përcaktuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me fond limit në shumën 3.066.848 lekë pa tvsh; si dhe është ngritur Njësia e Prokurimit, me tre anëtarë.

Me procesverbalin nr.263/25 datë 10.06.2022, Njësia e Prokurimit ka hartuar dhe miratuar dokumentat standarde të tenderit, kriteret e vlerësimit si dhe kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta të kualifikimit, i cili është miratuar nga Titullari.

Me shkresën nr.263/26, datë 10.06.2022 është bërë njoftimi i shkurtuar i kontratës ku është përcaktuar afati për paraqitjen dhe hapjen e ofertave data 23.06.2022 ora 10.00.

KVO, sipas procesverbalit nr.263/28, datë 23.06.2022, ka bërë hapjen e ofertave ku ka rezultuar se është paraqitur vetëm një operator ekonomik (Albania Motor Company).

KVO, sipas procesverbalit nr.263/29, datë 23.06.2022, ka bërë shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së vetme të paraqitur ku ka konstatuar se operatori plotëson kërkesat për kualifikim; oferta e paraqitur është në vlerën 2.890.000 lekë, pa tvsh; duke vendosur pranimin e ofertës.

KVO, me shkresën nr.263/30, datë 23.06.2022, ka hartuar raportin përmbledhës, duke propozuar njoftimin e fituesit me qëllim lidhjen e kontratës, raport i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor.

Me shkresën nr.263/31, datë 24.06.2022 është bërë njoftimi i fituesit.

Me shkresën nr.263/32, datë 28.06.2022 janë administruar oferta ekonomike dhe dokumentacioni i specifikimeve teknike.

Me shkresën nr.263/33, datë 29.06.2022, është administruar fatura tatimore elektronike nr.4062 /2022 datë 29.06.2022, për automjetin e prokuruar.

Me shkresën nr.263/34, datë 29.06.2022 është bërë nënshkrimi i kontratës së furnizimit.

Me shkresën nr.263/35, datë 29.06.2022 ka dalë Urdhëri i Titullarit për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të automjetit.

Me shkresën nr.263/36, datë 29.06.2022 është hartuar plani i zbatimit të kontratës, dërguar në APP me shkresën nr.263/37 datë 30.06.2022.

Me shkresën nr.263/38, datë 30.06.2022, komisioni i marrjes në dorëzim ka marrë në dorëzim automjetin tip Ford Mondeo, me targë AB648GZ, viti prodhimit 2019, me 0 km të përshkuara.

Me shkresën nr.263/39, datë 04.07.2022, është dërguar në APP formulari i njoftimit të kontratës. Automjeti i marrë është bërë hyrje me fletë hyrjen nr.33 datë 29.06.2022.

Likujdimi i faturës është bërë me Urdhër Shpenzimit nr.136 datë 07.07.2022, në vlerën 3.468.000 lekë me tvsh.

Procedurat e prokurimeve për shërbimet e konsulencës; të kryera për hartimin e planeve vendore gjatë periudhës objekt auditimi, janë pasqyruar dhe trajtuar në sistemin e mësipërm.

Përsa më lart; grupi i auditimit konstaton parregullsi në dokumentimin e lëvizjes së aktiveve, konkretisht në momentin e bërjes hyrje të automjetit, pasi është bërë hyrje, pa u bërë me parë marrja në dorëzim e tij, duke vepruar në kundërshtim me Udhëzimin e M. Financave nr.30 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pika 37 ku thuhet tekstualisht: *Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletëhyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi të jetë bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i cmimit (Procesi i marrjes në dorëzim të aktiveve, referuar kushteve të percaktuara në kontratë).*

**Titulli i Gjetjes:** Rregullshmëria e dokumentimit të lëvizjes së aktiveve.

<b>Nr.i gjetjes: 3</b>	
<b>Subjekti i Audituar</b>	AKPT
<b>Njësitë/Subjektet interesuar nga gjetja</b>	AKPT MIE
<b>Përmbledhja e bazës ligjore</b>	Udhëzimi M. Financave nr.30 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar,
<b>Përshkrimi i gjetjes:</b>	<b>Situata:</b> Blerja e automjetit sipas Urdhër Prokurimit nr.13/1, datë 10.6.2022, është bërë hyrje në magazinë, pa u marrë më parë në dorëzim. Procesverbali i marrjes në dorëzim të automjetit ka datë 30.6.2022, ndërsa është bërë hyrje në magazinë sipas fletë hyrjes nr.33 datë 29.06.2022, pra një ditë më parë.

	<p><b>Kriteri:</b> Udhëzimi i M.Financave nr.30 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar; pika 37 "Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletëhyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi të jetë bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i cmimit (Procesi i marrjes në dorezim të aktiveve, referuar kushteve të percaktuara në kontratë)".</p> <p><b>Ndikimi/efekti:</b> Në rastin konkret nuk ka patur ndikim apo efekt, por mos funksionimi i kontrollit të brendshëm mund të sjellë pasoja në administrimin e aktiveve.</p> <p><b>Shkaku:</b> Mos funksionimi i kontrollit të brendshëm.</p>
<b>Vlerësimi i nivelit të riskut</b>	I mesëm
<b>Konkluzioni:</b>	Kontrolli i brendshëm, në rastin konkret, nuk ka funksionuar
<b>Rekomandimi:</b>	Nga Nëpunësi Zbatues, për çdo rast të lëvizjes së aktiveve, të bëhet kontrolli paraprak i dokumentacionit për rregullshmërinë e jashtme; zbatimin e ligjshmërisë, saktësinë e veprimeve artmetikore ligjore dhe renditjen kronologjike të tyre.
<b>Afati i fundit për zbatimin e rekomandimeve</b>	Menjëherë dhe në vazhdimësi.
<b>Statusi i rekomandimit</b>	Për tu kompletuar në kohën e hartimit të Raportit Përfundimtar.

Rregullshmëria e procedurave të kryera për prokurimin e fondeve, për blerjet me vlera të vogla.

Prokurimi i fondeve për mallra dhe shërbime kryhet me burim financimi nga fondet e buxhetit të shtetit.

Në zbatim të dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve publike, çdo vit, Titullari i Autoritetit Kontraktues, ka ngritur komisionin e prokurimit me vlerë të vogël: konkretisht me Urdhër të Brendshëm nr.2 datë 05.01.2021, prot nr.11, ka krijuar komisionin për prokurimin me vlerë të vogël për vitin 2021 dhe me Urdhër të Brendshëm nr.2 datë 05.01.2022, prot nr.11, ka krijuar komisionin për prokurimin me vlerë të vogël për vitin 2022.

Me urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr.1, datë 05.01.2021, prot.nr.10, është caktuar personi përgjegjës për prokurimet për vitin 2021.

Me urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr.1, datë 05.01.2022, prot.nr.03, është caktuar personi përgjegjës për prokurimet për vitin 2022.

Grupi i auditimit përzgjedhi dhjetë procedura prokurimi për blerje me vlerë të vogël, e konkretisht pesë procedura nga viti 2021 dhe pesë procedura nga viti 2022, duke u bazuar në vlerën e tyre, në procedurën e përzgjedhur si dhe tipin e kontratës, të cila po i pasqyrojmë në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Objekti i prokurimit	Tipi i Kontratës	Lloji i procedurës	Fondi limit	Vlera e kontratës me tvsh	Operatori fitues
-----	----------------------	------------------	--------------------	-------------	---------------------------	------------------

Viti 2021						
1	Blerje libra profesionale	Mall	Blerje e vogël	906.154	954.000	Naim Hysi
2	Marrje automjet me qera	Shërbim	Blerje e vogël	655.833	748.003	Bledar Broshka
3	Blerje materiale pastrimi dhe dezinfektimi	Mall/Shërbim	Blerje e vogël	600.000	468.840	Xh.N.Sh M. Visoka V. Osmani Hep 2012
4	Blerje karburanti	Mall	Blerje e vogël	600.000	405.000	Gega Center
5	Blerja mat. kancelari	mall	Blerje e vogël	960.000	690.240	Librari durrahu Paperclip al.
Viti 2022						
1	Blerje libra profesional	Mall	Blerje e vogël	1.000.000	869.200	Genci Duka
2	Sherbim lyerje mirembajtje ndertese	Sherbim	Blerje e vogël	960.000	338.600	Murati BA
3	Sherbim perkthim redaktim, perkthim simultan	Sherbim	Blerje e vogël	1.000.000	1.067.664	Ëe Translate Al.
4	Sherbim shtypshkrime	Sherbim	Blerje e vogël	1.000.000	893.760	Kujtim Drizari Kristalina KH
5	Pajisje kompjuterike	Mall	blerje e vogël	1.000.000	1.025.760	Euro Inform

Për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël me përzgjedhje nga grupi i auditimit, rezultoi se:  
 -Nga Autoriteti Kontraktor procedurat e blerjeve me vlera të vogla me mjete elektronike janë realizuar në përputhje me VKM nr.914, datë 29.12.2014, neni 40 pika 1 (paragrafi i parë) 2,3,5,8; Udhëzimin e APP-së nr.3 datë 08.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar: VKM nr.285 datë 19.05.2021, neni 11 dhe 56 si dhe Udhëzimi i APP-së nr.05, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike".

-Autoriteti Kontraktor ka realizuar prokurimin e blerjeve me vlera të vogla me rrugë elektronike, (për grup mallrash apo shërbimesh) ku vlera e përlogaritur e tyre nuk është më e madhe se 1.000.000 lekë në zbatim të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 40, pika 4 si dhe Udhëzimit nr.3, 08.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar;

Për çdo blerje ka dalë urdhëri i prokurimit ku është përcaktuar natyra, sasia e mallrave, shërbimeve të cilat kërkohen të prokurohen si dhe fondi limit i përlogaritur më parë. Komisioni i blerjeve me vlera të vogla ka përcaktuar fitues operatorin ekonomik bazuar në kriterin e çmimit më të ulët.

Në çdo rast për furnizimin e mallrave apo kryerjen e shërbimeve, nga subjektet respektive është lëshuar Faturë tatimore elektronike, në zbatim të Ligjit nr.87/2019 "Për Faturën dhe Sistemin e Monitorimit të Qarkullimit".

-Në të gjitha procedurat për blerje me vlera të vogla, për periudhën objekt auditimi, në çdo rast nga Titullari i Institucionit është ngritur komisioni i marjes në dorëzim të mallrave apo shërbimeve, në përputhje me pikën 42 të Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.

### **Opinion i Përgjithshëm mbi funksionimin e sistemit:**

Në përfundim të auditimit vlerësojmë se në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, janë konstatuar të meta e parregullsi që çënojnë funksionimin e komponentëve të kontrollit të brendshëm. Komponentet e kontrollit të brendshëm në këtë sistem, kryesisht, janë vlerësuar nga niveli më i lartë i menaxhimit.

Procedurat për blerjet me vlera të vogla, me mjete elektronike, janë realizuar në përputhje me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik; Udhëzimin e APP nr.3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar; VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; Udhëzimin nr.05, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” por, janë konstatuar parregullsi në hyrjen e aktiveve ku: Aktivi i blerë është bërë hyrje në magazinë para se të merrej në dorëzim, veprim ky në mospërputhje me pikën 37 të Udhëzimit të M.Financave nr.30 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar”.

*Për sa më lart, grupi i auditimit vlerëson se kontrolli i brendshëm ka funksionuar në të gjitha hallkat e këtij sistemi. Risku vlerësohet i mesëm.*

### **5. Sistemi i pagave të punonjësve.**

#### *Objektivi i auditimit:*

Vlerësimi nëse procedurat e pagesave janë kryer në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe nëse janë të shoqëruara me dokumentacionin mbështetës, vërtetues e justifikues.

#### *Fushat të cilat do të merren në konsideratë gjatë auditimit:*

- Respektimi i strukturës organike të miratuar për periudhën objekt auditimi.
- Respektimi i ligjshmërisë dhe rregullshmërisë për pagesat e punonjësve, llogaritja e pagave në përputhje me vendin e punës dhe pagën e miratuar, përpilimi i dokumentacionit vërtetues të prezencës në punë të punonjësve.
- Rregullshmëria në krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë. Dhënia e shpërblimeve për rezultate në punë, ndihma për fatkeqësi, për nevoja kulturore, etj.
- Auditimi i kontabilizimit dhe shlyerjes së detyrimeve për tatimin mbi të ardhurat personale, sigurimet shoqërore e shëndetësore të punonjësve, etj.

#### *•Respektimi i strukturës organike të miratuar për periudhën objekt vlerësimi*

Për periudhën objekt auditimi, në AKPT struktura organike është e miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr.42, datë 02.03.2020 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së AKPT”, numri i punonjësve është miratuar me 41 punonjës.

Nga auditimi i të dhënave në listë prezencë dhe listëpagesat e punës, duke i kryqëzuar me përcaktimet e emërtimeve në strukturë, për periudhën 2021 dhe 2022, rezulton se struktura organizative është brenda numrit të punonjësve të miratuar me Urdhërin nr. 42, datë 02.03.2020 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së AKPT”.

#### *•Administrimin e dosjeve të personelit dhe regjistrin të personelit.*

Në AKPT në zbatim të VKM nr.833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrin qendror të personelit”, janë

administruar dosjet e personelit të çdo të punësuar, me të dhëna të karakterit të përgjithshëm profesional, akademik, masat disiplinore, vlerësimet periodike të rezultateve individuale në punë si dhe të dhëna të tjera, sipas lidhjeve 1 e 2 që i bashkëlidhen këtij vendimi.

• *Procedurat e rekrutimit të punonjësve:*

Marrëdhëniet e punës së punonjësve të AKPT rregullohen sipas Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit. Për periudhën e auditimit (viti 2021 dhe viti 2022) janë rekrutuar 42 punonjës, përkatësisht 25 punonjës për vitin 2021 dhe 17 punonjës për vitin 2022.

Për rekrutimin e punonjësve gjatë periudhës object auditimi është bërë identifikimi i vendeve të lira të punës dhe shpallja e tyre në faqen zyrtare të AKPT.

Është bërë administrimi i të gjitha aplikimeve, si dhe verifikimi paraprak i tyre nëse përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim. Aplikantët të cilët plotësojnë kërkesat e posaçme dhe të përgjithshme të pozicionit të punës, janë njoftuar se janë përzgjedhur për fazën e intervistës.

Nga Komisioni i Vlerësimit janë shqyrtuar CV e kandidatëve të përzgjedhur në fazën e parë të konkurimit si dhe janë bërë vlerësimet e kryera gjatë fazës së dytë të konkurimit (intervistimi me gojë) të dokumentuara nëpërmjet një proces verbali.

Aplikanti i cili është përzgjedhur fitues nga anëtarët e komisionit është njoftuar dhe ka lidhur kontratë me institucionin sipas kriterëve të caktuara në Kodin e Punës.

• *Procedurat e largimeve nga puna:*

Për periudhën e auditimit (viti 2021 dhe viti 2022) janë larguar nga puna 51 punonjës, përkatësisht 25 punonjës për vitin 2021 dhe 26 punonjës për vitin 2022 kryesisht nëpërmjet dorëheqjes.

Referuar dokumentacionit të dosjeve të personelit, rezulton se për punonjësit e larguar nga puna nëpërmjet dorëheqjes, janë zbatuar të gjitha procedurat konform nenit 8.1/a "Zgjidhja e kontratës" të kontratës individuale të punës, lidhur ndërmjet punësdhënësit, D.P i AKPT dhe punëmarrësit.

• *Respektimi i ligjshmërisë dhe rregullshmërisë për pagesat e punonjësve, pagesa të prapambetura, llogaritja e pagave në përputhje me vendin e punës dhe pagën e miratuar, përpilimi i dokumentacionit vërtetues të prezencës në punë të punonjësve.*

Për auditimin e sistemit të pagave u përdor metoda e testimit hap pas hapi me teknik të auditimit me përzgjedhje (10 punonjës për secilin vit) nga listë prezencat në listë pagesat e punonjësve, pasqyrimin e tyre në librin e pagave si dhe rakordimi i pagës neto me shumën e hedhur në llogarinë bankare, për secilin punonjës.

Nga auditimi i respektimit të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë për pagesat e punonjësve u konstatua se është zbatuar korrekt VKM nr.187 datë 08.03.2017 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabinetëve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës ..." pagesa e shtesës për pozicion, sipas Lidhjes nr.1 dhe pagesa për llojin e diplomës, sipas Lidhja nr.2.

Për punonjësit mbështetës pagesat për punën e kryer janë në zbatim të VKM nr.202, datë 15.03.2017 Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.717, datë 23.06.2009 "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore", të ndryshuar, lidhja nr.1.

Llogaritja e pagës së cdo punonjësi është kryer në përputhje me vendin e punës dhe pagën e miratuar në dispozitat ligjore të lartpërmendur.



Nga struktura përgjegjëse pagesat janë kryer për punonjësit faktik, prezent në punë. Prezenca në punë e punonjësve është e dokumentuar me përpilimin e dokumentacionit vërtetues të prezencës në punë, me listëprezencë.

• *Rregullshmëria në krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë. Dhënia e shpërblimeve për rezultate në punë, ndihma për fatkeqësi, për nevoja kulturore, etj.*

Për periudhën objekt auditimi nuk u konstatuan raste të pagesave për punë jashtë kohës normale të punës si dhe të pagesave për shtesa mbi pagë, apo raste të dhënies së shpërblimeve për rezultate në punë.

Nga auditimi i rregullshmërisë në krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë, u konstatua se:

-Për vitin 2021, është akorduar fondi i veçantë prej 238,000 lekë nga i cili është përdorur në vlerë totale prej 208,530 lekë e detajuar si vijon:

Shuma prej 85,530 është përdorur për daljen në pension të një punonjësi;

Shuma prej 32,000 lekë është përdorur për pagesën e telefonit të titullarit,

Shuma prej 90,000 lekë është përdorur për ndihmë financiare.

-Për vitin 2021, është akorduar fondi i veçantë prej 238.000 lekë nga i cili është përdorur në vlerë totale prej 208,530 lekë e detajuar si vijon:

Shuma prej 35,178 lekë është përdorur për pagesën e telefonit të titullarit;

Shuma prej 500,000 lekë është përdorur për ndihmë financiare në zbatim të VKM nr. 898 date 29.12.2022 "Për mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të njërive të qeverisjes së përgjithshme dhe institucioneve të arsimit të lartë publik për zbutjen e krizës".

Pas shqyrtimit të dokumentacionit grupi i auditimit vlerëson se fondi i veçantë është përdorur në përputhje me kriteret e përcaktuara në VKM nr.929, datë 17.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë", të ndryshuar dhe VKM nr.898 date 29.12.2022 "Për mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të njërive të qeverisjes së përgjithshme dhe institucioneve të arsimit të lartë publik për zbutjen e krizës".

• *Auditimi i kontabilizimit dhe shlyerjes së detyrimeve për tatimin mbi të ardhurat personale, sigurimet shoqërore e shëndetësore të punonjësve, etj.*

Nga auditimi i përllogaritjeve dhe derdhjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat, në të gjitha listë pagesat e punonjësve që u përzgjedhën për periudhën që auditohet, u konstatua se është respektuar kufiri minimal dhe maksimal si dhe përllogaritja dhe ndalesat si për detyrimet që ka punëdhënësi ndaj organeve të sigurimeve shoqërore shëndetësore dhe ato që ka punëmarrësi, janë llogaritur saktë në zbatim të VKM nr.1114, datë 30.07.2008 "Për disa ceshtje në zbatim ligjeve nr.7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; Ligjin nr.9136, datë 11.09.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.23, datë 09.12.2014 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore" si dhe tatimi mbi të ardhurat personale janë mbajtur punonjësve konform Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" të ndryshuar; Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.5, datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar.

Për çdo muaj detyrimet tatimore dhe sigurimeve shoqërore shëndetësore janë raportuar saktësisht dhe brenda afateve ligjore pranë institucioneve përkatëse.

### **Opinion i Përgjithshëm mbi funksionimin e sistemit:**

*Grupi i auditimit vlerëson:*

-Lidhur me respektimin e strukturës organike auditimi nuk konstatoi të meta.

- Punonjësit janë paguar me paga sipas pagës së vendeve të punës së miratuar.
  - Kontrollet e brendshme lidhur me dokumentimin kanë funksionuar në mënyrën e duhur.
  - Ndalesat e përlllogaritura për tatimet, taksat, kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, janë bërë në mënyrë korrekte dhe janë derdhur në kohën e duhur.
- Kontrolli i brendshëm ka funksionuar në të gjitha hallkat dhe *vlerësohet me risk të ulët*.

## 6. Sistemi i menaxhimit të aktiveve, kontabilizimi dhe raportimi financiar.

### *Objektivi i auditimit:*

Vlerësimi nëse procesi i regjistrimit, dokumentimit dhe lëvizjes së aktiveve funksionon në pajtueshmëri me legjislacionin përkatës si dhe të sigurohet se procedurat janë efikase dhe të mbështetura në dokumentacionin vërtetues. Vlerësimi nëse mbajtja e kontabilitetit dhe raportimi financiar janë kryer në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe SKK.

### *Fushat të cilat do të merren në konsideratë gjatë auditimit:*

- Organizimi i mbajtjes, azhurnimit, regjistrimit kronologjik të transaksioneve në ditarë dhe librat e kontabilitetit. Bilanci kontabël dhe dhënia e opinionit për saktësinë dhe vërtetësinë e posteve të tij dhe pasqyrave financiare.
- Rregullshmeria e dokumentimit të detyrimeve financiare të prapambetura në kontabilitet.
- Rregullshmëria e raportimit financiar.
- Rregullshmëria e evidentimit dhe pasqyrimit të aseteve të institucionit në regjistrin e aseteve dhe në pasqyrat financiare të tij.
- Rregullshmëria e kryerjes së inventarizimit fizik të aktiveve, dokumentimit të marrjes në dorëzim të aktiveve dhe lëvizjeve të tyre.

Referuar strukturës së Institucionit, miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr.42, datë 02.03.2020, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së agjencisë kombëtare të planifikimit të territorit”, mbajtja e kontabilitetit është organizuar brenda Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve mbështetëse, nga Sektori i Financës, i cili funksionon me organikë prej 3 punonjësish (pergjegjës sektori dhe 2 specialistë) dhe detyrat funksionale të kësaj strukture janë të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Funksionimit të AKPT-së. Nëpunësi zbatues (Drejtori i Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse), ka varësi direkte nga Titullari Institucionit.

Struktura e ngarkuar me mbajtjen e kontabilitetit dhe raportimin e pasqyrave financiare, është e njohur me dispozitat ligjore dhe nënligjore të veprimtarisë si dhe me ato të përdorimit të fondeve buxhetore dhe ushtron aktivitetin në ambiente pune dhe me infrastrukturë mbështetëse të kompletuar. Kjo njësi ka organizuar komunikimin me strukturat e tjera si dhe formën e raportimit.

Në këtë institucion, për periudhën objekt auditimi, është organizuar mbajtja e kontabilitetit dhe janë kryer procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore si njësi buxhetore, mbështetur në dispozitat mbi kontabilitetin për institucionet buxhetore, konkretisht në Udhëzimin nr.8, date 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në NJQP”.

Në këtë njësi publike, për periudhën objekt auditimi, evidentohet se mbajtja e kontabilitetit bëhet duke përdorur programin “Alpha Buxhetor”. Njëpërmjet këtij programi kryhen veprimet kontabile në zbatim të kërkesave të përcaktuara në ligjin nr.25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe

pasqyrat financiare" dhe UMF nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme".

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga sektori i financës dhe janë nënshkruar nga NA dhe NZ. Në drejtim të mbajtjes së kontabilitetit, regjistrimit të veprimeve ekonomiko financiare, evidentohet se:

Janë regjistruar veprimet dhe transaksionet ekonomiko financiare; është ruajtur vijimesia në pasqyrimin në mënyrë kronologjike të veprimeve dhe ngjarjeve ekonomike; është respektuar klasifikimi kontabël i llogarive në raportimin e pasqyrave financiare për entitetet buxhetore; është ruajtur krahasueshmëria e të dhënave midis dy periudhave raportuese; si dhe është mbajtur e njëjta politikë kontabël për periudhën ushtrimore.

Për çeljet, përdorimin e fondeve dhe marrëdhënien me buxhetin e shtetit janë bërë rakordime periodike e vjetore me degën e thesarit.

Sipas evidencës kontabël dhe pasqyrave financiare të raportuara, në fund të periudhave 2022 dhe 2021, AKPT ka raportuar dhe paraqitet me këtë situatë të pozicionit financiar për gjendjen pasurore, detyrimet dhe fondet e veta të institucionit:

Pasqyra e pozicionit financiar

në lekë

Referenca e Logarive	EMERTIMI	Ushtrimi i mbyllur 2022	Ushtrimi i mbyllur 2021	Ushtrimi i mbyllur 2020
<b>A</b>	<b>AKTIVET</b>	<b>177,872,998</b>	<b>215,485,114</b>	<b>223,365,888</b>
	<b>I.Aktivët Afat shkurtra</b>	<b>26,730,886</b>	<b>30,155,566</b>	<b>23,804,922</b>
	<b>I.Mjete monetare dhe ekujvalent të tyre</b>	<b>2,044,958</b>	<b>5,512,958</b>	<b>54,647</b>
531	Mjete monetare ne Arke			
512,56	Mjete monetare ne Banke			
520	Disponibilitete ne Thesar	2,044,958	5,512,958	54,647
	<b>2.Gjendje Inventari qarkullues</b>	<b>19,802,330</b>	<b>19,441,921</b>	<b>18,479,464</b>
31	Materiale	6,310,653	6,830,820	6,860,643
32	Inventar I imet	13,491,677	12,611,101	11,618,821
	<b>3.Llogari te Arketushme</b>	<b>4,883,598</b>	<b>5,200,687</b>	<b>5,270,811</b>
411	Kliente e llogari te ngjashme			
423,429	Personeli, parardhenie, deficite, gjoba	14,155	14,155	14,155
468	Debitore te ndryshem	1,435,253	1,435,253	1,435,253
4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	3,434,190	3,751,279	3,821,403
	<b>4.Te tjera aktive afatshkurtra</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
	<b>II.Aktivët Afat gjata</b>	<b>151,142,112</b>	<b>185,329,547</b>	<b>199,560,966</b>
20	<b>1.Aktive Afatgjata jo materiale</b>	<b>137,785,883</b>	<b>172,000,401</b>	<b>186,219,901</b>
202	Studime dhe kerkime	137,785,883	172,000,401	186,219,901
21	<b>2.Aktive Afatgjata materiale</b>	<b>13,356,229</b>	<b>11,156,489</b>	<b>13,341,065</b>
210	Toka, Troje, Terene			
211	Pyje, Plantacione			
212	Ndertesat e Konstruksione			
213	Rruge, rrjete, vepra ujore	49,668	62,085	77,606
214	Instalime teknike, makineri e paisje	4,503,392	4,929,779	5,931,006
215	Mjete Transporti	3,600,747	599,434	820,708
218	Inventar ekonomik	5,202,422	5,565,191	6,511,745
24	Aktive afatgjata te demtuara			
25-26	<b>3.Aktive Afatgjata Financiare</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
23	<b>4.Investime</b>	<b>-</b>	<b>2,172,657</b>	<b>-</b>
230	Per Aktive Afatgjata jo materiale		2,172,657	
231	Per Aktive Afatgjata materiale			

<b>B</b>	<b>PASIVET(DETYRIMET)</b>	<b>4,949,298</b>	<b>5,266,387</b>	<b>5,325,458</b>
	<b>I.Pasivet Afat shkurtra</b>	<b>4,949,298</b>	<b>5,266,387</b>	<b>5,325,458</b>
	<b>I. Llogari te Pagushme</b>	<b>4,949,298</b>	<b>5,266,387</b>	<b>5,325,458</b>
401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	107,084	83,224	102,967
42	Detyrime ndaj personelit	2,306,679	2,552,947	2,590,362
431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	225,681	235,480	245,361
435	Sigurime Shoqerore	694,382	766,154	774,488
436	Sigurime Shendetsose	96,364	106,480	108,225
466	Kreditore per mjete ne ruajtje	65,700	65,700	54,647
467	Kreditore te ndryshem	4,000	6,994	-
4341	Operacione me shtetin( detyrime	1,449,408	1,449,408	1,449,408
	<b>2.Te tjera pasive afatshkurtra</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
	<b>II.Pasivet Afat Gjata</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>C</b>	<b>AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)</b>	<b>172,923,700</b>	<b>210,218,727</b>	<b>218,040,430</b>
<b>D</b>	<b>FONDI I KONSOLIDUAR :</b>	<b>172,923,700</b>	<b>210,218,727</b>	<b>218,040,430</b>
101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	170,584,033	201,636,355	216,683,909
12	Rezultatet e mbartura			
85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	2,339,667	6,409,715	1,356,521
111	Rezerva			
115	Nga Fondet e veta te investimeve			
15	Shuma te parashikuiara per rreziqe e Zhvleresime			
105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshme		2,172,657	
106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja			
107	Vlera e mjeteve te caktuara ne perdorim			
109	Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata			
	Te Tjera			
<b>E</b>	<b>TOTALI I PASIVEVE(B+C)</b>	<b>177,872,998</b>	<b>215,485,114</b>	<b>223,365,888</b>

Në analizën mbi rregullshmërinë e raportimit të pozicionit financiar, mbështetur në dokumentacionin e paraqitur dhe investiguar nga grupi i auditimit, rezultoi se:

#### **Pasqyra e pozicionit financiar (F1)**

**Aktivët neto janë të barabarta me Aktivët – Pasivët = 172,923,700 lekë për vitin 2022 dhe 210,218,727 lekë për vitin 2021.**

- A. Aktivët 177,872,998 lekë (v.2022) dhe 215,485,114 lekë (v.2021)  
 B. Pasivët (Detyrimet) 4,949,298 lekë (v.2022) dhe 5,266,387 lekë (v.2021)  
 C. Aktivët neto 172,923,700 lekë (v.2022) dhe 210,218,727 lekë (v.2021)

#### **A. Aktivët e AKPT përbëhen nga:**

##### **I. Aktivët Afatshkurtra**

Aktivët afatshkurtra paraqiten në vlerën 26,730,886 lekë në fund të vitit 2022 dhe 30,155,566 lekë në fund të vitit 2021. Këto aktive përbëhen nga:

1. Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 2,044,958 lekë në fund të vitit 2022 dhe 5,512,958 lekë në fund të vitit 2021;
2. Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 19,802,330 lekë në fund të vitit 2022 dhe 19,441,921 lekë në fund të vitit 2021;
3. Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën shumën 4,883,598 lekë në fund të vitit 2022 dhe 5,200,687 lekë në fund të vitit 2021.

#### **1. Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre”, përbëhet nga:**

- **Llogaria 520 "Disponibilitete në Thesar"**, sipas pasqyrave financiare të vitit 2022 paraqitet në vlerën prej 2,044,958 lekë dhe në pasqyrat financiare të vitit 2021 paraqitet në vlerën prej 5,512,958 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën V "Teprica në fillim të vitit ushtrimor" në vlerën 54,647 lekë për vitin 2021 dhe në vlerën 5,512,958 lekë për vitin 2022 dhe rubrikën VI "Teprica e likuiditeve në fund të vitit ushtrimor" në vlerën 5,512,958 lekë për vitin 2021 dhe në vlerën 2,044,958 lekë për vitin 2022 (sipas formatit F3 "Pasqyra e flukseve monetare").  
Gjatë periudhës objekt auditimi kjo llogari ka pësuar shtesa dhe pakësime:

Përshkrimi	Viti 2022	Viti 2021
<b>I. Të trashëguara nga Viti Paraardhës</b>		
<i>Të trashëguara nga Granti/Të ardhurat</i>	5,447,258	
<i>Mjete në ruajtje të trashëguara (llog. 466)</i>	65,700	54,647
<b>Totali I</b>	<b>5,512,958</b>	<b>54,647</b>
<b>II. Të hyrat (Shtesat debitore) gjatë vitit</b>		
<i>Akordim i Fondeve nga Buxheti Shpenzime Korente</i>	66,169,450	70,210,000
<i>Akordim i Fondeve nga Buxheti Shpenzime Kapitale</i>	30,844,132	66,708,410
<i>Të hyra nga mjetet në ruajtje</i>		24,000
<i>Të hyra, Sponsorizime nga të tretë</i>		5,447,258
<b>Totali II</b>	<b>97,013,582</b>	<b>142,389,668</b>
<b>Totali I lëvizjes debitore (I+II)</b>	<b>102,526,540</b>	<b>142,444,315</b>
<b>III. Lëvizjet kreditore të llogarisë 520</b>		
<i>Pagesa për shpenzime Korente</i>	55,313,411	55,372,735
<i>Pagesa për Investime</i>	10,986,715	24,480,691
<i>Të dala nga mjetet në ruajtje (466)</i>		12,947
<i>Kthim në buxhetin e shtetit</i>	34,181,456	57,064,984
<b>Totali III Totali I lëvizjes kreditore</b>	<b>100,481,582</b>	<b>136,931,357</b>
<b>Teprica debitore (I+II) – III =</b>	<b>2,044,958</b>	<b>5,512,958</b>

Për verifikimin e shumave të mësipërme u mor në analizë ditari i bankës, akt-rakordimet me degën e thesarit Tiranë dhe rezultoi se nuk ka diferenca.

Gjithashtu për verifikimin e llogarisë 520 u verifikua gjendja analitike e kësaj llogarie sipas të cilës kjo llogari përbëhet nga:

Përshkrimi	Viti 2022	Viti 2021
Garanci të ngurtësuar	65,700	54,647
Projekti BRIGAIID-	1,979,258	5,447,258
<b>Totali</b>	<b>2,044,958</b>	<b>5,501,905</b>

Nga analiza e gjendjes analitike të kësaj llogarie u evidentua se:

Shuma e garancive të ngurtësuar gjatë viteve objekt auditimi dhe shuma e mbartur nga projekti BRIGAIID -"Kapërcimi i barrierave në fushën e inovacionit me qëllim ripërtëritjen ndaj katastrofave" përputhet me akt-rakordin me Degën e Thesarit Tiranë.

## 2. Llogaritë e Klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues", përbëhen nga:

Referenca e Llogarive	EMERTIMI	Ushtrimi i Mbyllur 2022	Ushtrimi i Mbyllur 2021	Ushtrimi i Mbyllur 2020
31	Materiale	6,310,653	6,830,820	6,860,643
32	Inventar I imet	13,491,677	12,611,101	11,618,821

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të AKPT paraqiten në shumën 19,802,330 lekë në fund 2022 dhe në shumën 19,441,921 lekë në fund të vitit 2021. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën -962,457 lekë për vitin 2021 dhe -360,409 lekë për vitin 2022 e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” pasqyrën e performancës.

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

- **Llogaria 31 “Materiale”** për vitin 2021 paraqitet në vlerën 6,830,820 lekë ndërsa për vitin 2022 paraqitet në vlerën 6,310,653 lekë.

Gjatë vitit 2021 kjo llogari ka pësuar rënie në vlerën 29,823 lekë nga viti paraardhës. Kjo rënie vjen si diferencë midis hyrjeve nga blerjet e reja për vitin 2021 në vlerën 2,803,839 lekë dhe daljeve të këtij viti në vlerën 2,833,662 lekë.

Gjatë vitit 2022 kjo llogari ka pësuar rënie në vlerën 520,567 lekë nga viti paraardhës. Kjo rënie vjen si diferencë midis hyrjeve nga blerjet e reja për vitin 2022 në vlerën 2,961,851 lekë dhe daljeve të këtij viti në vlerën 3,482,018 lekë.

Gjendja e kësaj llogarie është e njëjtë me inventarin fizik të kryer nga njësia çdo vit sipas kërkesave të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

- **Llogaria 32 “Inventar i Imët”** për vitin 2021 paraqitet në vlerën 12,611,101 lekë ndërsa për vitin 2022 paraqitet në vlerën 13,491,677 lekë.

Gjatë vitit 2021 kjo llogari ka pësuar rritje në vlerën 99,228 lekë nga viti paraardhës. Kjo shtesë vjen nga blerjet e reja në shumën 99,228 lekë.

Gjatë vitit 2022 kjo llogari ka pësuar rritje në vlerën 880,576 lekë nga viti paraardhës. Kjo shtesë vjen si diferencë midis hyrjeve nga blerjet e reja për vitin 2022 në vlerën 882,976 lekë dhe daljeve të këtij viti në vlerën 2,400 lekë.

### 3. Llogaritë Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhet nga:

Referenca e Llogarive	EMERTIMI	Ushtrimi i Mbyllur 2022	Ushtrimi i Mbyllur 2021	Ushtrimi i Mbyllur 2020
	<b>3.Llogari te Arketushme</b>	<b>4,883,598</b>	<b>5,200,687</b>	<b>5,270,811</b>
411	Kliente e llogari te ngjashme			
423,429	Personeli, paradhenie, deficite, gjoba	14,155	14,155	14,155
468	Debitore te ndryshem	1,435,253	1,435,253	1,435,253
4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	3,434,190	3,751,279	3,821,403

Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra”, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të AKPT paraqiten në shumën 4,883,598 lekë në fund 2022 dhe në shumën 5,200,687 lekë në fund të vitit 2021.

**Llogaria 423,429 “Personeli, paradhenie, deficite, gjoba”**, paraqitet në vlerën 14,155 lekë për të dyja vitet objekt auditimi. Kjo llogari e analizuar dhe përfaqëson një detyrim të mbartur nga vitet paraardhëse.

**Llogaria 468 "Kërkesa për arkëtim mbi debitorë të ndryshëm"**, paraqitet per 1,435,253 lekë për të dyja vitet objekt auditimi dhe përfaqëson detyrimet e debitorëve të trashëguara nga vitet e mëparshme të detajuara si vijon:

- 1) ISP Urbanistika në vlerë 619,840 lekë, referuar urdhërit të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit nr.35, datë 08.03.2010 ku citohet që "Aktivet dhe Pasivet e AKPT-së do të jenë aktivet dhe pasivet e bilancit të ISPU-së";
- 2) Projekti Speedy në vlerë detyrimi prej 123,318 lekë konstatuar në raportin final të auditit të MZHU-së Nr. 1347/2 datë 04.03.2015, detyrim i ardhur si rezultat i mos kthimit të kësaj vlere AKPT-së si njësi zbatuese e këtij projekti (pagesë e bërë me buxhetin e AKPT-së dhe e rimbussuar nga projekti Speed si rezultat i mungesës së fondeve).
- 3) Kreuza Leka në vlerë detyrimi prej 182,781 lekë, detyrim i konstatuar në raportin final të auditit të MZHU-së nr.1347/2 datë 04.03.2015, për shërbim jashtë vendit, procedurë në kundërshtim me VKM-në nr.870, datë 14.12.2011.
- 4) Daniel Leka në vlerë detyrimi prej 217,710 lekë, detyrim i konstatuar në raportin final të auditit të MZHU-së nr.1347/2, datë 04.03.2015 si rezultat i mungesës së disa artikujve në magazinë.
- 5) Isilda Halili në vlerë detyrimi prej 217,710 lekë, detyrim i konstatuar në raportin final të auditit të MZHU-së nr.1347/2, datë 04.03.2015 si rezultat i mungesës së disa artikujve në magazinë.
- 6) Loreta Shehu në vlerë detyrimi prej 30,000 lekë, detyrime të konstatuara në vitin 2017, referuar vendimit të Agjencisë së Prokurimit Publik nr.55, datë 28.06.2017 me objekt "Shqyrtim raport Auditimi".
- 7) Enola Bejko në vlerë detyrimi prej 120,000 lekë, detyrime të konstatuara në vitin 2017, referuar vendimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.55, datë 28.06.2017, me objekt "Shqyrim Raport Auditimi" si anëtare e NJ.P.
- 8) Deni Klosi në vlerë detyrimi 29,400 lekë, detyrim i konstatuar gjatë vitit 2020 si rezultat i mungesës së një asemi në magazinë.

Gjatë periudhës objekt auditimi, konkretisht gjatë vitit 2022, nga ana e AKPT janë dërguar shkresa kundrejt debitorëve për pagesën e detyrimit të tyre kundrejt institucionit.

**-Llogaria 4342 "Operacione me shtetin"** të drejta të arkëtueshme, (financim i pritshëm nga buxheti) paraqitet në shumën 3,434,190 lekë në fund të vitit 2022 dhe në shumën 3,751,279 lekë në fund të vitit 2021, dhe përfaqësojnë detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit).

Kjo llogari është e analizuar dhe është e njëjtë me detyrimet e papaguara të AKPT në fund të vitit 2021 dhe 2022 si më poshtë:

	Viti 2022	Viti 2021	Viti 2020
<b>Llogari të arkëtueshme</b>	<b>3,434,190</b>	<b>3,751,279</b>	<b>3,821,403</b>
Operacione me shtetin(Te drejta)	3,434,190	3,751,279	3,821,403
<b>Llogari të pagueshme</b>	<b>3,434,190</b>	<b>3,751,279</b>	<b>3,821,403</b>
Furnitorë e llogari të lidhura me to	107,084	83,224	102,967
Detyrime ndaj personelit	2,306,679	2,552,947	2,590,362
Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	225,681	235,480	245,361
Sigurime Shoqërore	694,382	766,154	774,488
Sigurime Shëndetsore	96,364	106,480	108,225
Kreditorë të ndryshem	4,000	6,994	-

## II. Aktivët Afatgjatë

Aktivët Afatgjatë paraqiten në vlerën 151,142,112 lekë në fund të vitit 2022 dhe 185,329,547 lekë në fund të vitit 2021. Aktivët Afatgjatë të AKPT përbëhen nga:

-Aktive Afatgjatë Jo Materiale të cilat janë raportuar klasifikuar në 1 grupim kontabël në llogarinë 202 "Studime dhe Kërkime";

- Aktive Afatgjatë Materiale të cilat janë raportuar klasifikuar në 4 grupime kontabël, respektivisht në llog 213 "Rrugë, Rrjete, Vepra Ujore"; në llog 214 "Instalime Teknike, Makineri e Pajisje"; në llog 215 "Mjete Transporti"; në llog 218 "Inventar Ekonomik".

- Investime të cilat janë raportuar klasifikuar në 2 grupime kontabël respektivisht në llogarinë 230 Për Aktive Afatgjatë Jomateriale dhe 231 Për Aktive Afatgjatë Materiale.

**1. Llogaritë e Klasës 20 "Aktivët Afatgjatë JoMateriale",** AAJM sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2022, vlera kontabël neto paraqitet në shumën 137,785,883 lekë. Në vitin paraardhës 2021, vlera kontabël neto e AAM-ve paraqitet në shumën 172,000,401 lekë, me një ulje të AAJM-ve në shumën 34,214,518 lekë. Ndërsa sipas formatit 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjatë (kosto historike)" paraqiten në mbylljen e vitit ushtrimor 2022 në vlerën 254,001,264 lekë dhe në fund të vitit ushtrimor 2021 në vlerën 250,563,264 lekë.

Referenca e Logarive	EMERTIMI	Ushtrimi i Mbyllur 2022	Ushtrimi i Mbyllur 2021	Ushtrimi i Mbyllur 2020
20	2.Aktive Afatgjatë Jomateriale	137,785,883	172,000,401	186,219,901
202	Studime dhe kërkime	137,785,883	172,000,401	186,219,901

- **Llogaria 202 "Studime e kërkime"** paraqitet me kosto historike në vlerën 254,001,264 lekë për vitin 2022 dhe në vlerën 250,563,264 lekë për vitin 2021.

Vlera neto e kësaj llogarie e paraqitur në aktivin e pasqyrës së Pozicionit Financiar paraqitet në vlerën 137,785,883 lekë për vitin 2022 dhe në vlerën 172,000,401 lekë për vitin 2021.

Kjo llogari ka pësuar shtesa gjatë vitit përkatësisht në vlerën 8,235,933 lekë për vitin 2022 dhe në vlerën 21,733,554 lekë për vitin 2021. Kjo rritje vjen nga kapitalizimi i investimeve për aktive afatgjatë jomateriale, konkretisht:

Për vitin 2021:

Nr	Përshkrimi	Vlera
1	Plan i Detyruar Vendor për ZDP , 130 banesa individuale, Bashkia Durres	2,352,000
2	Plan i Detyruar Vendor për ZDP ,57 banesa individuale,Bashkia Kurbin dhe Bashkia Shijak	920,000
3	Plan i Detyruar Vendor për ZDP , 134 banesa individuale ,Bashkia Vore	1,920,000
4	Plan i Detyruar Vendor për ZDP , 42 banesa individuale ,Bashkia Kurbin	761,000
5	Plan i Detyruar Vendor për ZDP , 25 banesa individuale ,Bashkia Shijak	588,000
6	Plan i Detyruar Vendor për 56 banesa individuale B. Rrogozhine	950,000
7	Plan i Detyruar Vendor për ZDP , 42 banesa individuale B. Lezhe	1,028,201
8	Plan i Detyruar Vendor për ZDP , arkeologjike, zona Nj.A Durres, B. Durres	7,844,000
9	Plan i Detyruar Vendor për ZDP , 3 banesa kolektive, B. Kurbin	490,000
10	Plan i Detyruar Vendor për ZDP , 194 banesa kolektive, B. Lezhe	2,085,953
11	Plan i Detyruar Vendor për ZDP , 114 banesa individuale , B. Kamez, B. Durres, B. Vore	2,144,400
12	Plan i Detyruar Vendor për ZDP , 34 banesa individuale , B. Shijak	650,000
<b>Totali</b>		<b>21,733,554</b>

Për vitin 2022:

Nr.	Përshkrimi	Vlera
1	Plan i Detyruar Vendor për ZDP ,10 banesa kolektive , B. Kruje	650,000
2	Plan i Detyruar Vendor për ZDP ,50 banesa kolektive , B. Vore	408,000
3	Plan i Detyruar Vendor për ZDP ,180 banesa kolektive , B. Kurbin, B. Shijak	2,380,000



4	Itinerari Kulturor Gjurmet Fishtiane faza I	4,797,933
	<b>Totali</b>	<b>8,235,933</b>

Për të verifikuar saktësinë e kryerjes së kapitalizimeve të investimeve të mësipërme, nga grupi i auditimit u shqyrtuan procedurat si vijon:

- Për vitin 2021

1)	Plan i Detyruar Vendor per ZDP, 57 banesa individuale ,Bashkia Kurbin dhe Bashkia Shijak	920,000
2)	Plan i Detyruar Vendor per ZDP, arkeologjike, zona Nj.A Durres, B. Durres	7,844,000
3)	Plan i Detyruar Vendor per ZDP, 194 banesa kolektive, B. Lezhe	2,085,953
4)	Plan i Detyruar Vendor per ZDP, 114 banesa individuale , B. Kamez, B. Durres, B. Vore	2,144,400

-Për vitin 2022

1)	Plan i Detyruar Vendor per ZDP, 180 banesa kolektive , B. Kurbin, B. Shijak	2,380,000
2)	Itinerari Kulturor Gjurmet Fishtiane faza I	4,797,933

Pas shqyrtimit të dokumentacionit justifikues rezulton se kapitalizimi i investimeve është bërë në përputhje me Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Për çdo rast kapitalizimi është bërë mbështetur në aktin përkatës së marrjes në dorëzim të aktivitetit. Gjatë periudhës objekt auditimi llogaria 202 “*Studime e kerkime*” ka pësuar këto pakësime:

Gjatë vitit 2022 kjo llogari është pakësuar në vlerën 4,797,933 nga kalimi kapital i projektit Itinerari Kulturor Gjurmet Fishtiane faza I. Kalimi kapital është bërë mbështetur në Vendimin nr.209, datë 03.06.2022 të Këshillit Kombëtar për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë.

Gjithshtu kjo llogari ka pësuar pakësim nga amortizimi në vlerën 37,652,518 lekë gjatë vitit 2022 dhe në vlerën 35,953,054 gjatë vitit 2021.

*Grupi i Auditimit vlerëson se Amortizimi i aktiveve që i përkasin llogarisë 202 “Studime e Kerkime” është llogaritur në përputhje me pikën 36 të Udhëzimit nr.8 date 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.*

**2. Llogaritë e Klasës 21 “Aktivet Afatgjata Materiale”,** AAM sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2022, vlera kontabël neto paraqitet në shumën 13,356,229 lekë. Në vitin paraardhës 2021, vlera kontabël neto e AAM-ve paraqitet në shumën 11,156,489 lekë, me një rritje të AAM-ve në shumën 2,199,740 lekë. Ndërsa sipas formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbylljen e vitit ushtrimor 2022 në vlerën 45,018,064 lekë dhe në fund të vitit ushtrimor 2021 në vlerën 40,094,625 lekë.

Referenca e Logarive	EMERTIMI	Ushtrimi i Mbyllur 2022	Ushtrimi i Mbyllur 2021	Ushtrimi i Mbyllur 2020
21	2.Aktive Afatgjata materiale	13,356,229	11,156,489	13,341,065
213	Rruge, rrjete, vepra ujore	49,668	62,085	77,606
214	Instalime teknike, makineri e paisje	4,503,392	4,929,779	5,931,006
215	Mjete Transporti	3,600,747	599,434	820,708
218	Inventar ekonomik	5,202,422	5,565,191	6,511,745

- **Llogaria 213 “Rruge, rrjete, vepra ujore”** paraqitet me kosto historike në vlerën 121,260 lekë e cila lidhet me Instalimin e një Pompe Uji. Vlera neto e kësaj llogarie e paraqitur në aktivin e

pasqyrës së Pozicionit Financiar paraqitet në vlerën 49,668 lekë për vitin 2022 dhe në vlerën 62,085 lekë për vitin 2021.

Pakësimi në vlerën 12,417 lekë gjatë vitit 2022 dhe në vlerën 15,521 lekë gjatë vitit 2021 vjen nga amortizimi vjetor i aktiveve që i përkasin kësaj llogarie.

*Grupi i Auditimit vlerëson se Amortizimi i ndërtesës është llogaritur në përputhje me pikën 36 të Udhëzimit nr.8 date 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".*

- **Llogaria 214 "Instalime teknike, Makineri dhe Pajisje"** paraqitet në pasqyrën e Pozicionit Financiar në vlerën neto 4,503,392 lekë në vitin 2022 dhe në vlerën neto 4,929,779 lekë në vitin 2021.

Gjatë vitit 2022 kjo llogari ka pësuar shtesë në vlerën 429,679 lekë e cila vjen nga kapitalizimi i investimeve të reja në aktive afatgjata materiale që i përkasin vitit 2022.

Pakësimi në vlerën 856,066 lekë gjatë vitit 2022 dhe në vlerën 1,001,227 lekë gjatë vitit 2021 vjen nga amortizimi vjetor i aktiveve që i përkasin kësaj llogarie.

*Grupi i Auditimit vlerëson se Amortizimi i ndërtesës është llogaritur në përputhje me pikën 36 të Udhëzimit nr.8 date 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".*

- **Llogaria 215 "Mjete Transporti"** paraqitet në vlerën neto 599,435 lekë në fund të vitit 2022 dhe në vlerën 3,600,748 lekë në fund të vitit 2021.

Kjo llogari ka pësuar shtesa gjatë vitit 2022 në vlerë totale 3,468,000 lekë të cilat vinë nga kapitalizimi i investimit në aktive afatgjata materiale gjatë vitit 2022.

Kjo llogari është pakësuar gjatë vitit 2021 dhe 2022 si vijon:

Gjatë vitit 2021 ka pasur nxjerrje jashtë përdorimi të makinës Autoveture Lada Niva me vlerë neto 71,415 lekë .

Gjithashtu, llogaria 215 "Mjete Transporti" është pakësuar nga amortizimi vjetor në vlerën 149,858 lekë për vitin 2021 dhe në vlerën 466,687 lekë për vitin 2022.

*Amortizimi i Aktiveve që i përkasin kësaj llogarie është llogaritur në përputhje me pikën 36 të Udhëzimit nr.8 date 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".*

-**Llogaria 218 "Inventar Ekonomik"** paraqitet në vlerën neto 5,202,422 lekë në vitin 2022 dhe në vlerën 5,565,191 lekë për vitin 2021.

Kjo llogari ka pësuar shtesa gjatë periudhës objekt auditimi në vlerë 1,025,760 lekë gjatë vitit 2022 dhe në vlerë 574,480 lekë të cilat vinë nga kapitalizimi i investimeve në aktive afatgjata materiale në vitet përkatëse.

Gjithashtu kjo llogari ka pësuar pakësime nga amortizimi vjetor i aktiveve në vlerën 1,521,034 lekë gjatë vitit 2021 dhe në vlerën 1,388,529 lekë gjatë vitit 2022.

*Amortizimi i Aktiveve që i përkasin kësaj llogarie është llogaritur në përputhje me pikën 36 të Udhëzimit nr.8 date 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".*

Gjendja e kësaj llogarie është e njëjtë me inventarin fizik të kryer nga njësia çdo vit sipas kërkesave të Udhëzimit të M. Financave nr.30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik".

3. **Llogaritë e Klasës 23 "Investime"** sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2022, vlera kontabël paraqitet në shumën 137,785,883 lekë. Në vitin paraardhës 2021, vlera kontabël neto e AAM-ve paraqitet në shumën 172,000,401 lekë, me një ulje të AAJM-ve në shumën 34,214,518 lekë.

Referenca e Logarive	E M E R T I M I	Ushtrimi i Mbyllur 2022	Ushtrimi i Mbyllur 2021	Ushtrimi i Mbyllur 2020
23	4.Investime	-	2,172,657	-
230	Per Aktive Afatgjata jo materiale		2,172,657	
231	Per Aktive Afatgjata materiale			

- **Llogaria 230 "Investime për Aktive Afatgjata JoMateriale"** paraqitet me vlerë 0 lekë për vitin 2022 dhe në vlerën 2,172,675 lekë për vitin 2021.

Gjatë periudhës së auditimit kjo llogari ka pësuar shtesë nga investimet e reja në vlerën 23,906,211 lekë për vitin 2021 dhe në vlerën 6,063,276 lekë gjatë vitit 2022.

Kjo llogari ka pësuar pakësime gjatë vitit 2021 në vlerën 21,733,554 dhe 8,235,933 lekë për vitin 2022. Këto pakësime vinë nga kapitalizimi i investimeve afatgjata jomateriale në llogarinë 202 "Studime e Kërkime".

- **Llogaria 231 "Investime për Aktive Afatgjata Materiale"** paraqitet me vlerë 0 lekë për vitin 2022 dhe në vlerën 0 lekë për vitin 2021.

Gjatë periudhës së auditimit kjo llogari ka pësuar shtesë nga investimet e reja në vlerën 574,480 lekë për vitin 2021 dhe në vlerën 4,923,439 lekë gjatë vitit 2022.

Kjo llogari ka pësuar pakësime gjatë vitit 2021 në vlerën 574,480 lekë dhe 4,923,439 lekë për vitin 2022. Këto pakësime vinë nga kapitalizimi i investimeve afatgjata materiale në llogaritë e grupit 21 "Aktive Afatgjata Materiale".

**B. Pasivet (Detyrimet)**, janë raportuar të klasifikuara në grupin "Detyrime afatshkurtra". Entiteti nuk ka "detyrime te pagueshme" apo "hua te marra", afatgjata.

Gjendja detyrime afatshkurtra, në fund të vitit 2022 paraqitet për vlerën totale 4,949,298 lekë ndërsa në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 5,266,387 lekë, e raportuar me analizë sipas llogarive:

-**Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to"**, në fund të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 107,084 lekë dhe në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 83,224 lekë. Kjo llogari paraqet detyrimet e muajit Dhjetor të vitit përkatës të cilat për periudhën objekt auditimi paraqiten në mënyrë të detajuar si vijon:

Përshkrimi	2022	2021
Telefon	5,760	5,844
Ujë	1,668	2,688
Energji Elektrike	62,596	74,692
Posta	37,060	-
<b>Totali</b>	<b>107,084</b>	<b>83,224</b>

-**Llogaria 42, "Detyrime ndaj personelit"**, paraqitet në vlerën 2,306,679 lekë për vitin 2022 dhe në vlerën 2,552,947 lekë për vitin 2021 dhe përfaqëson detyrimin e muajit dhjetor të vitit përkatës për paga.

**-Llogaria 431, “Detyrime ndaj shteti për tatim taksa”,** paraqitet në vlerën 225,681 lekë për vitin 2022 dhe në vlerën 235,480 lekë për vitin 2021 dhe përfaqëson detyrimin e muajit dhjetor të vitit përkatës për tatimin mbi të ardhurat personale dhe për tatimin në burim.

**-Llogaria 435, “Sigurime shoqërore”** paraqitet në vlerën 694,382 lekë për vitin 2022 dhe në vlerën 766,154 lekë për vitin 2021 dhe përfaqëson detyrimin e muajit dhjetor të vitit përkatës për Sigurime shoqërore.

**-Llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”** paraqitet në vlerën 96,364 lekë për vitin 2022 dhe në vlerën 106,480 lekë për vitin 2021 dhe përfaqëson detyrimin e muajit dhjetor të vitit përkatës për tatimin mbi të ardhurat personale.

**-Llogaria nr.466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”,** paraqitet në vlerën 65,700 lekë për të dyja vitet objekt auditimi.

Gjatë vitit 2021 kjo llogari ka pësuar shtesë në vlerën 24,000 lekë nga ngurtësimi i garancisë për investimin “Blerje Smartboard”.

Gjithashtu gjatë këtij viti kjo llogari ka pësuar ulje në vlerën 12,947 lekë nga pagesa e garancisë për sigurimin e kontratës Blerje Smartboard. Gjatë vitit 2022 kjo llogari nuk ka pësuar ndryshime. Teprica kreditore e kesaj llogarie nga njesia mbahet e analizuar me subjekte dhe perfaqeson vlerat per 5% te garancite te kontratave te punimeve dhe ngurtesime fondesh ne thesar. *Kjo llogari është e rakorduar edhe me degen e thesarit Tiranë.*

**-Llogaria 467 “Kreditorë te ndryshem”,** paraqitet në vlerën 4,000 lekë për vitin 2022 dhe në vlerën 6,994 lekë për vitin 2021,

Teprica kreditore e kesaj llogarie paraqet detyrimin për telefonin celular të titullarit për muajin Dhjetor të vitit paraardhës.

**- Llogaria 4341 “Të tjera operacione me shtetin (detyrime)”** me vlera të pandryshuara për periudhën objekt auditimi dhe që lidhen me saldot debitore te llog.423,429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” dhe llog. 468 “Kerkesa për arketim mbi debitorë të ndryshëm”.

**C. Aktivët Neto, fondet e entitetit,** ne fund te vitit 2022 paraqiten per 4,879,253,104 lekë nga 3,685,439,733 leke ne fund te vitit 2021.

Nga njesia aktivet neto jane raportuar te klasifikuara në:

**- Llogaria 101 “teprica fondi i akumuluar”** në fund të vitit 2022 për 32,710,539 lekë dhe në krahasim me vitin 2021 paraqitet me një ulje për 3,910,149 lekë.

**- Llogaria 85 “rezultati i veprimtarise ushtrimore”,** ku evidentohet se njesia gjendjen në këtë llogari ne fund te vitit 2022 dhe vitit 2021e ka paraqitur të pandryshuar dhe paraqet shumën e mbartur në vite në debi të llogarisë 520 “Disponibilitete në Thesar”. Kjo shumë duhet të ishte kaluar tek llogaria 12 “Rezultate të mbartura”. Rekomandimi lidhur me shumën e përfshirë në këtë llogari është lënë në fillim të këtij materiali.

**- Gjithashtu njësia ka raportuar klasifikuar *fond i konsoliduar “të tjera”*** për vitin 2022 vlerën 4,839,659,649 leke dhe për vitin 2021 vleren 3,641,593,005 lekë, vlera të cilat evidentohet se kanë si llogari korespondente llog. 231 “Investime per aktivet afatgjata materiale”, ne vazhdim e proces. Me analizë vlera e raportuar ne bilancin e vitit 2021, perbehet dhe lidhet me 10 objekte, dhe për vitit 2022 përbehet dhe lidhet me 28 objekte per investime ne proces.

### **Raportimi i pasqyrave financiare dhe rakordimet me degën e thesarit.**

Mbyllja dhe raportimi i pasqyrave financiare, evidentohet se është bërë mbeshtetur në Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8 datë 9.3.2018 “Pë procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësite e qeverisjes së përgjithshme”. Raportimi i pasqyrave financiare për vitin ushtrimor 2021 dhe 2022, paraqitet i plotë në drejtim të plotësimit të pasqyrave financiare dhe formateve përkatëse përcaktuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8 datë 9.3.2018 “Pë procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësite e qeverisjes së përgjithshme”.

Janë raportuar pasqyrat financiare vjetore për periudhën ushtrimore 2021 dhe 2022 pranë Degës së Thesarit Tiranë, si dhe në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, respektivisht për vitin 2021 me shkresën nr.396, datë 23.02.2022 protokolluar nga Dega e Thesarit me nr.1285, datë 24.02.2022 dhe për vitin 2022 raportuar me shkresën nr.238, datë 22.02.2023 protokolluar nga Dega e Thesarit me nr.787/16, datë 24.02.2023.

Evidentohet se midis strukturës të financës të AKPT dhe sektorit të shpenzimeve në Degën e Thesarit Tiranë, është rakorduar për shpenzimet, me situacionet e shpenzimeve për periudhën Janar-Dhjetor 2021 dhe Janar-Dhjetor 2022, firmosur rregullisht nga palët, të cilat janë dërguar zyrtarisht edhe në organin epror MIE.

### **Rregullshmëria e kryerjes së inventarizimit fizik të aktiveve**

Inventarizimi është kryer në zbatim të kërkesave të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Për vitin 2021 dhe 2022, në institucion është kryer inventarizimi fizik i aktiveve, në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30 datë 27.12.2021, i ndryshuar, kapitulli IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve”, Inventarizimi i aktiveve; pika 74.

Titullari i institucionit për periudhën objekt auditimi ka lëshuar Urdhrat për kryerjen e inventarizimit të vlerave materiale, konkretisht:

-Me urdhërin nr.71, datë 10.11.2021 prot. me nr.1238, datë 10.11.2021 është ngritur komisioni për kryerjen e inventareve të aktiveve të trupëzuara dhe qarkulluese për vitin 2021 i përbërë nga 3 punonjës.

-Me urdhërin nr.104, datë 14.12.2022; me nr.1633 prot, datë 14.12.2022 është ngritur komisioni për kryerjen e për kryerjen e inventareve të aktiveve të trupëzuara dhe qarkulluese për vitin 2022, i përbërë nga 3 punonjës.

Përbërja e komisionit të inventarizimit të aktiveve të njësisë është e ndryshme në të dy vitet objekt auditimi, veprim ky në përputhje me pikën 84 të udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011, të ndryshuar, ku citohet “*inventarizimi periodik i aktiveve nuk mund të bëhet dy herë me radhë në të njëjtin vend nga i njëjti komision*”.

Lista e aktiveve për inventarizim është hartuar nga nëpunësi zbatues në bazë të të dhënave të regjistrave kontabël të aktiveve të njësisë, në përputhje me pikën 81 të udhëzimit, ku shprehimisht citohet se: “*Lista e aktiveve për inventarizim hartohet nga nëpunësi zbatues në bazë të të dhënave të regjistrave kontabël të aktiveve të njësisë*”.

Në zbatim të detyrave të përcaktuara në aktet ligjore të sipërcituara dhe në urdhrat respektivë të sipërpërmendur; nga komisionet e inventarizimit është kryer inventarizimi fizik për asetet e AKPT për vitet 2021 e 2022. Ky proces është dokumentuar me Relacionet përkatëse mbi kryerjen e inventarit vjetor të vlerave materiale në Agjencinë Kombëtare të Planikimit të Territorit, të cilët janë miratuar nga Drejtorit të Përgjithshëm i institucionit, konkretisht:

- Për vitin 2021 është kryer procesi i inventarizimit fizik të aktiveve dhe është dokumentuar me relacionin nr.1238/01 datë 07.12.2021 i cili është nënshkruar nga komisioni i Inventarizimit dhe është miratuar nga drejtori i përgjithshëm.

- Për vitin 2022 është kryer procesi i inventarizimit fizik të aktiveve dhe është dokumentuar me relacionin nr.1633/03 datë 29.12.2022, i cili është nënshkruar nga komisioni i Inventarizimit dhe është miratuar nga drejtori i përgjithshëm.

Komisioni i inventarizimit për të dy vitet ka bërë verifikimin sasior dhe cilësor të inventarit ku nuk janë konstatuar diferenca midis gjendjes kontabile dhe asaj fizike. Por gjatë dy viteve janë konstatuar aktive të dëmtuara

Janë hartuar listat e inventarit për secilën kartelë ku secila prej tyre është nënshkruar nga anëtarët e komisionit të inventarizimit dhe personi përgjegjës për inventarizimin.

Grupi i auditimit, pas shqyrtimit të shkresave të sipërcituara dhe fletëve të inventarizimit, vlerëson: Në institucion, janë organizuar dhe realizuar procedurat e inventarizimit të pasurisë si dhe raportimit, në zbatim të kërkesave të përcaktuara në Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar dhe të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.30 date 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të kësaj fushe.

#### **Opinion i Përgjithshëm mbi funksionimin e sistemit:**

Procedurat e mbajtjes, regjistrimit kronologjik të transaksioneve në ditarë dhe librat e kontabilitetit në AKPT, mbahet me program Financiar dhe veprimet janë të regjistruara në kontabilitet në mënyrë kronologjike e sistematike. Për çdo regjistrim kontabël është shënuar origjina, natyra, data dhe përmbajtja e veprimit ekonomik ose e ngjarjes.

Pasqyrat financiare paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri gjendjen financiare, performancën, ndryshimet në gjendjen financiare dhe rrjedhjen e parasë së AKPT. Ato janë përgatitur dhe paraqiten në përputhje me standardet kontabël. Llogaria vjetore e AKPT ka besueshmërinë për t'u konsideruar të rregullta.

Sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar ka funksionuar në përputhshmëri me Ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, si dhe Udhëzimin nr.8 date 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Në institucion, janë organizuar dhe realizuar procedurat e inventarizimit të pasurisë si dhe raportimit, në zbatim të kërkesave të përcaktuara në Ligjin Nr.10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar dhe të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.30 date 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të kësaj fushe.

Sa sipër kontrolli i brendshëm ka funksionuar në të gjitha hallkat e këtij sistemi, *Risku vlerësohet i ulët.*

**Vlerësimi i përgjithshëm i riskut:** Mbështetur në informacionin e disponuar në vlerësimin e krijimit e funksionimit të sistemeve të menaxhimit, realizimin e objektivave, megjithëse nga menaxhimi janë hartuar politikat sipas detyrimeve të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, ato nuk kanë gjetur zbatim të plotë, pasi janë konstatuar mangësi të paraqitura në këtë material për periudhën e audituar dhe si përfundim grupi i auditimit paraqet opinionin dhe shpreh vlerësimin e riskut në nivel të mesëm.

\* \* \*

Sa më sipër, paraqesim Projektraportin e Auditimit, me evidentimet dhe konstatimet lidhur me çështjet e audituara dhe vlerësimet paraprake të sistemeve që janë ngritur dhe kanë funksionuar në AKPT.

Projektraporti i Auditimit hartohet në tre kopje, nga të cilat, një kopje administrohet në protokollin e institucionit MIE, dy kopje i dërgohen institucionit të audituar, një prej të cilave, pasi nënshkruhet me ose pa vërejtjet përkatëse me shkrim, i kthehet grupit të auditimit.

**PËR AKPT-në**

**Drejtor i Përgjithshëm**

**Adelina GRECA**

**GRUPI I AUDITIMIT**

**Hikmet KASO**

**Kristina DELIU**



